ExLibris

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

çdo të shtunë

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 18 PRILL 2020. NUMËR 75. VITI II I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

Përkthyesi i shquar i letërsisë shqipe në rumanisht

Marius Dobrescu:

Kur një shkrimtar botohet në disa vende perëndimore të rëndësishme, kjo është si një certifikatë garancie

Po, mund t'ju them se kur ika nga Rumania për në Shqipëri isha student në vitin e parë në Fakultetin e Historisë. Më pëlqente historia, sidomos ajo e mesjetës ballkanike. Prandaj, duke qenë në Tiranë, i lexova me shumë pasion romanet e Kadaresë. Madje, punimi im për diplomën, në fund të vitit të katërt, ka pasur si temë *Rezistenca e popullit shqiptar gjatë shekujve të pasqyruar në veprën e Kadaresë*, me udhëheqës prof. Ali Xhikun. Kur u ktheva në Rumani, pas fakultetit, kisha dy valixhe: njëra me gjërat personale, tjetra me libra...

ANDRRA ASHT JETA...

Një sprovë mbi poezinë e Ledia Dushit

nga Fatmir Alimani

(*vijon nga numri i kaluar*)

(*fq. 17*)

NIKOLLË MEKAJSHI DHE KONTRIBUTI MADHOR I TIJ NË SHËRBIM TË KISHËS KATOLIKE SHQIPTARE

nga KUJTIM BEVAPI

...Relacioni fillon me fjalët: "Atë i lumtur! Gabimet kryesore të princave të sotëm janë: guxim i paktë nga frika e madhe, që të vihen të bëjnë punë të denja për ta. Prandaj ndodh që një lumturi e madhe, të cilën mund ta gëzonin, atyre nuk u vlen, sikundër një krevat ari, që nuk do t'i vlente një të sëmuri...". Vdiq në mërgim më 1615.

(*fq. 12*)

Dy sy si dy botë

-në përkujtim të letrarit Përtef Kruja-

nga Alban Gjata

(*fq. 15*)

Pandi Raidhi, ikonat dhe shtojzovallet

nga Xhevair Lleshi

(*fq. 14*)

TREGIME

Vath Koreshi: *I dashuri i saj i parë* (*fq. 9*)

Ramadan Bozhlani: *I dashur armik Koronavirus* (*fq. 10*)

STEFAN ÇAPALIKU

Virusi më përndjekë, por unë jam ma i shpejtë

-NGA DITARI I MARTIN CUKUT-

(*vijon nga numri i kaluar*)

(*fq. 6*)

(*fq. 18*)

Lamtumirë, mjeshtri Gianni Belluscio!

nga Adil OLLURI

(*fq. 11*)

Ditët e njejta

cikël poetik nga

Manjola Brahaj

(*fq. 8*)

LEXUES TË MIRË DHE SHKRIMTARË TË MIRË

Vladimir Nabokov

Veçanësia e Jup Kastratit në studimin e letërsisë arbëreshe

nga Prof. Klara Kodra

(*fq. 5*)

Përkthyesi i shquar i letërsisë shqipe në rumanisht

Marius Dobrescu:

Kur një shkrimtar botohet në disa vende perëndimore të rëndësishme, kjo është si një certifikatë garancie

Intervistoi: Bujar Hudhri

Gjysmë shekulli më parë Marius Dobrescu, një student njëzetvjeçar, zbriti nga avioni i linjës Bukuresht-Tiranë në aeroportin pothuaj pa udhëtarë të Rinasit. Ky fluturim do t'ju ndryshonte jetën përgjithmonë. Çfarë mbani mend sot nga ajo ditë e largët?

Ishte data 14 qershor 1971 kur, së bashku me Filip Teodorescun, më vonë ambasador i Rumanisë në Tiranë, zbrita nga avioni i kompanisë gjermane *Interflug* në aeroportin e Rinasit. Në sallonin e aeroportit na pritën përfaqësuesit e Universitetit të Tiranës dhe ata të ambasadës sonë. Nga Universiteti kishte ardhur shefi i administratës, njëfarë Eyupi, dhe njëri nga pedagogët që punonin me studentët e huaj, kurse nga ambasada ishte Sekretari i saj i Parë, Nicolae Stânea. Ambasador ishte Manole Bodnăraş-i, vëllai i një shefi komunist të asaj kohe. Që në fillim vumë re se gjuha shqipe ishte një gjuhë e ashpër dhe duke i dëgjuar shqiptarët kur flisnin, në veten time e krahasova aty për aty me zhurmën e një guri që rrëshqet mbi çati. Përshtypjet e para nuk ishin inkurajuese. Në ajër zotëronte duhma e vajullirit të prishur, njerëzit ishin veshur shumë modest dhe mbi të gjitha, ishte shumë, shumë vapë. Kudo, në çdo qoshe të rrugës, kishte fshatarë me gomarë dhe thasë në shpinë ose qytetarë që prisnin autobusin. Shumë prej tyre e pinin kafenë direkt në trotuar, para ëmbëltoreve. Gjatë rrugës nga aeroporti për në qytet kishte ca shtëpi të varfra, të mbuluara me kashtë, me dy-tri pula pikaloshe në oborr. Varfëria ishte prezente kudo. Por kishte edhe gjëra të mira. P.sh., u miqësuam shpejt me studentët e fakultetit, me ata të kursit të fundit që ishin akoma në konvikt, dhe dilnim me ta në lulishte, tek ora e qendrës, ku kishte muzikë, qofte dhe bërxolla, birrë në kriko etj. Ose shkonim me ta në Durrës, në plazh, me ata trenat e mbushur të linjës Tiranë-Durrës. Ditën e parë, pas aeroportit, Eyupi na çoi në restorant *Donika*, ku hëngrëm drekë: supë dhe kofshë pule me patate të skuqura. Ne vinim nga Rumania, një vend i zhvilluar në ato vite, me një regjim komunist pak a shumë liberal, dhe çdo gjë rreth nesh na u duk e çuditshme.

Po, vërtet, erdhët në një vend të izoluar, ndërsa Rumania ishte nga më liberalet e vendeve të kampit socialist. Por kjo nuk është se ju prishte punë fort. Ju kishit ardhur për të studiuar dhe shkolla shqiptare atëherë ishte e një niveli shumë të lartë . Në Fakultetin Gjuhë-Letërsi, për shembull, si mësimdhënës ishin atëkohë gjuhëtarët më të mirë shqiptarë. Si e vlerësoni këtë mundësi?

Po, patjetër, mund të them se kemi pasur mësimdhënës shumë të mirë, akademikë, shkrimtarë etj. Duke filluar me akademik Shaban Demirajn që jepte gramatikë historike, Myzafer Xhaxhiu letërsi antike, Fatmir Agalliu morfologji, Nasho Jorgaqi, Nexhip Gami, Ali Xhiku, letërsi etj. Midis tyre ishte edhe Ismaili. Te Kadareja më bëri përshtypje mënyra se si na shpjegonte letërsinë "dekadente" perëndimore, Proust, Joyce, Ionesco etj, pa hyrë në komente politike, pa zbatuar udhëzimet e ideologëve të Partisë. Ishte një prezencë më se normale, duke dalë nga skematizmi i asaj kohe.

Në fakultet prezenca në leksione ishte e detyrueshme. Në fillim, shënimet i mbanim rumanisht, pastaj direkt shqip. Kishim edhe tekste universitare që në atë kohë ishin shumë të lira. Punonim shumë në bibliotekën e fakultetit, ku shkonim gati çdo ditë. Midis shokëve të kursit kishim disa ish-sportistë, si puna e Neptun Bajkos, që vazhdonte për gjuhë-letërsi me ne. Ne të dy, unë dhe Filipi, ishim të vetmit studentë të huaj nga Europa, të tjerët ishin vietnamezë, kinezë, indonezianë, bolivianë dhe dy a tre zezakë. Mbaj mend se ishim në vitin e tretë, para provimit të historisë së PPSH-së, kur na thirri ambasadori ynë në selinë e ambasadës dhe na urdhëroi të mos përgjigjemi në disa pyetje që kishin lidhje me partitë revizioniste, siç ishte konsideruar edhe partia jonë komuniste. Kemi pasur fat, nuk na ra ndonjë pyetje e tillë.

Keni pasur pedagog të jashtëm Kadarenë i cili që atëherë, duhet pranuar, pas "Gjeneralit...", ishte bërë i famshëm në botë. Ndoshta këtu është zanafilla juaj si përkthyes i tij?

Po, mund t'ju them se kur ika nga Rumania për në Shqipëri isha student në vitin e parë në Fakultetin e Historisë. Më pëlqente historia, sidomos ajo e mesjetës ballkanike. Prandaj, duke qenë në Tiranë, i lexova me shumë pasion romanet e Kadaresë. Madje, punimi im për diplomën, në fund të vitit të katërt, ka pasur si temë *Rezistenca e popullit shqiptar gjatë shekujve të pasqyruar në veprën e Kadaresë*, me udhëheqës prof. Ali Xhikun. Kur u ktheva në Rumani, pas fakultetit, kisha dy valixhe: njëra me gjërat personale, tjetra me libra. Midis tyre, të gjithë librat e Ismailit. Atë kohë te ne ishte Foqion Miçaço ai që përktheu *Gjeneralin e ushtrisë së vdekur*, në vitin 1973, roman që mbeti e vetmja vepër e Kadaresë deri në vitin 1983, kur publikova *Kronikë në gur*.

Tani në shtypin rumun sa herë përmendet Kadareja, përmendet edhe emri juaj. Do ta quaja këtë nivelin më të lartë të një përkthyesi. A e kishit lexuar Kadarenë në rumanisht para se të mësonit shqipen?

Ashtu siç ju thashë, Kadareja ishte përkthyer rumanisht pikërisht në kohën kur unë isha në Tiranë, pra nuk e lexova dhe nuk kisha dëgjuar asnjëherë për



një shkrimtar me këtë emër para se të vija në Tiranë. Por mund të them se përkthimi i Foqion Miçaços qe shumë i mirë. Librin e kam lexuar pas vitit 1975, kur isha kthyer në Rumani. Kur bëra versionin tim, pra kur e përktheva vetë, në vitin 2002 – që atëherë *Gjenerali...* "im" ka pasur edhe dy ribotime, – as nuk e preka me dorë librin e Foqion Miçaços. Punova sikur ai libër nuk ekzistonte fare, me qëllim që të mos ndikohesha prej tij.

Jeni shprehur me fjalë lavdëruese (ju çmoj shumë për këtë gjest) për përkthyesin e parë të Kadaresë, Foqion Miçaçon. A mund të na tregoni për lexuesin diçka më shumë rreth tij?

Për Foqion Miçaçon nuk di asgjë personale, ishte shumë i moshuar në vitet '70. Në vitet '78-'79 kam njohur rastësisht të venë e tij, që shiste librat e bibliotekës personale. Atëherë mësova se Foqioni kishte përkthyer edhe nga shqiptarë të tjerë.

"Kronika" ishte libri i parë që përkthyet në rumanisht më 1983. Jam shumë kurioz të di se si vendosët të bëheshit përkthyes? Sepse janë pafund studentët e gjuhëve të huaja dhe një numër fare modest prej tyre bëhen përkthyes. Keni një shpjegim?

Shpjegimi është shumë i thjeshtë. Në jetën time kam lexuar shumë, kryesisht letërsi historike, autorë romakë, grekë dhe bizantinë. Jam adhurues i qytetërimit romak dhe atij të Egjiptit antik. Orienti më ka magjepsur që në fëmini. Prandaj kam filluar si student për histori në Bukuresht, në vitin 1970. Besoj se kjo vjen nga fakti se jam lindur në qytetin e Naum Veqilharxhit, Brăila, qytet historik buzë Danubit, ish-sanxhak otoman, me shumë minoritete dhe historira romantike. Prandaj, duke arritur në Shqipëri, kam gjetur aty një copë nga orientalizmi im imagjinar, njerëz, vende dhe zakone të cilat i ndieja shumë të afërta. Prej këtij deri te romanet e para të Kadaresë, si *Kështjella*, *Kronikë në gur*, *Gjenerali...* rruga qe e shkurtër. Përkthimi, puna me librin, më është bërë një natyrë e dytë.

A mund të bëjmë një bilanc se sa vepra keni përkthyer nga Kadareja? Si botuesi i tij, e di se ai ju çmon shumë si përkthyes dhe si mik. Ndërkohë, përveç lexuesit rumun, keni pasur shumë vlerësime nga shteti shqiptar dhe ai rumun. A e lehtëson paksa kjo punën e mundimshme të përkthyesit?

Patjetër. Puna e përkthyesit është jashtëzakonisht e vështirë. Mund të shtoj tani, shumë e vlefshme për shtëpitë botuese. Unë konsideroj se mund të kesh sukses në këtë punë vetëm duke zotëruar shumë mirë gjuhën në të cilën përkthen, pra gjuhën rumune në rastin tim. Në Rumani kemi disa përkthyes të letërsisë shqipe. Tre a katër prej tyre janë shqiptarë, të natyralizuar te ne pas viteve '90. Mirë, por duke mos e ditur rumanishten shumë mirë, me nuancat më të holla, me finesë, puna e tyre nuk është në nivelin superior. P.sh., është përkryer para disa vjetësh libri i Edi Ramës "Kurban". Përkthimi qe i dobët, shumë i dobët, dhe e zbret vlerën e librit. Por ka edhe shembuj të tjerë.

Puna ime u vlerësua nga shteti shqiptar i cili më ofroi Medaljen e Mirënjohjes në vitin 2012 dhe gjithashtu, nga Lidhja e Shkrimtarëve të Rumanisë e cila më dha dy herë Çmimin e Parë për Përkthim. Po ashtu edhe Shoqata e Shkrimtarëve Shqiptarë të Amerikës në vitin 2010. Duke u kthyer te pyetja e parë, kam llogaritur deri tani 29 vëllime të botuara nga vepra e Kadaresë, me mbi 45 vepra. Sivjet do të publikohet nga shtëpia botuese *Humanitas* edicioni i tretë i *Gjeneralit...* dhe në tetor *Mëngjeset në Kafe Rostand*. Por jo vetëm Kadareja.

Keni gati dyzet vjet që përktheni Kadarenë. Para dhe pas rënies së komunizmit. Kadareja vazhdon të shkruajë ende, por ka zëra që bëjnë dallim në letërsinë e Kadaresë, duke e ndarë qartë në këto dy periudhat që përmendëm. Markezi thotë diku se përkthyesi është lexuesi më i vëmendshëm në botë. A mund të na jepni një përgjigje se si e shihni ju këtë raport midis dy periudhave në krijimtarinë e Kadaresë?

Kjo pyetje u bë shumë herë në shtypin letrar shqiptar dhe jo vetëm. Dhe po, ka disa dallime midis dy periudhave të përmendura prej jush. Veprat e periudhës socialiste janë më narrative, tematikat janë të integruara në realitetin e epokës: bllokada imperialiste, p.sh., mbledhja e Moskës, revolucioni kulturor i Maos dhe kështu me radhë. Dhe nuk mund të ishte ndryshe, derisa në Shqipërinë enveriste të jesh shkrimtar ishte një zanat tejet i rrezikshëm. Pastaj, kjo ka të bëjë edhe me moshën e shkrimtarit. Vepra e periudhës parisiane është më europiane si shkrim, disa herë eliptike, me simbole dhe shumë nuanca autobiografike. Por duket qartë se në të është shkrirë përvoja shqiptare e autorit. Është vepra e një profesionisti të vërtetë, me talent të madh dhe eksperiencë shkrimi.

Librat e Kadaresë nuk janë libra komercialë; ata shiten ngadalë, por besnikërisht ndaj lexuesit dhe botuesit, vazhdojnë të shiten çdo ditë. Po ashtu, çdo ditë botohet ose ribotohet një libër i Kadaresë në gjuhët e botës. Kjo është letërsia e nivelit të lartë. Shtëpia botuese *Humanitas*, me të cilën bashkëpunoni prej kohësh, këtë vit mbush një dekadë që boton Kadarenë. I kam prekur me dorë në panairet ndërkombëtare këta libra dhe janë të një niveli të lartë paraqitja dhe shtypi i tyre. A mund të na flisni shkurt për botuesen Denisa Comănescu?

Patjetër. Denisa Comănescu është drejtoresha letrare e shtëpisë botuese *Humanitas*. Është poeteshë e njohur, por (si edhe unë) i është dedikuar qind për qind punës për botimin e librave të të tjerëve, duke lënë pas dore veprën e vet. E kam njohur në vitet '80, si redaktore të shtëpisë botuese *Univers*, ku kam



publikuar prozat e para të Kadaresë. Pas vitit '90 ajo vajti te *Polirom*, ku mori me vete edhe dashurinë për Kadarenë dhe botuam së bashku shtatë vepra të tjera. Kur iku nga *Polirom*, na mori të dyve, Kadarenë dhe mua, te *Humanitas*, ku vazhduam kolanën Kadare. Kjo dashuri për Ismailin e çon Denisën deri në absurd, duke u bërë shumë xheloze atëherë kur unë kam një ofertë tjetër. Më në fund, bën çmos për të pasur atë titull në planin e vet.

Media rumune është shumë e vëmendshme dhe vlerësuese ndaj Kadaresë. Si e shpjegoni ju këtë?

Shkurtimisht, kjo vjen nga vlera e këtij autori. Është e qartë se, megjithëse në botë dalin ditë për ditë mjaft shkrimtarë të rinj, shumë të talentuar, disa nga ata të vjetrit, të njohurit e kontinentit, siç janë Kadareja, Kundera etj., mbeten në kulm të vlerësimit tonë.

Roli i përkthyesit është shumë i rëndësishëm, sidomos në botën e letërsisë. Ju keni përkthyer edhe autorë të tjerë nga letërsia shqipe, por që nuk kanë pasur vijimësi në rumanisht. Shkrimtarët e vendeve tona janë përballë një konkurrence të pabarabartë me mijëra shkrimtarë të të gjitha kohërave dhe të gjithë botës. Këtu vijmë te një problem i mprehtë. Lexuesi europianolindor është shumë i prirë ndaj letërsisë perëndimore. Unë vetë jam botues dhe e ndiej këtë presion, si dhe vështirësinë për të futur në treg autorë nga Ballkani. Keni një ide se si mund të zgjidhet ky ngërç? Mos kërkohet ndërhyja e institucioneve kulturore të shtetit? E bëjnë këtë vende të mëdha dhe me një kulturë shumëshekullore, si Franca, të përmendim një shembull.

Patjetër, pa ndihmën e shtetit kjo nuk bëhet. Letërsia shqipe ka mjaft shkrimtarë të mirë, duke filluar nga klasikët e deri te modernët. Mirëpo, një shtëpi botuese është kudo, në fund të fundit, një ndërmarrje private dhe çdo centimetër katror letre ka çmimin e vet. Ajo nuk mund të bëjë vepra bamirësie. Prandaj, botuesi duhet të jetë i sigurt se publikimi i një libri nuk do t'i sjellë humbje. Te ne, problemi ka dy lloje zgjidhjesh: ose vepra sponsorizohet nga individë apo institucione të ndryshme, ashtu siç dolën librat e disa autorëve shqiptarë në Rumani, si Edi Rama, Fate Velaj, Agim Isaku, kur ishte këshilltar ministri etj., ose botuesi kërkon ndihmën e shtetit, të Ministrisë së Kulturës. Tjetër rrugë nuk ka. Kjo për sa iu përket autorëve të panjohur. Ndryshe është atëherë kur një shkrimtar botohet në disa vende perëndimore të rëndësishme, kjo duke qenë një certifikatë garancie që merret parasysh.

A mund të na flisni për pagesat e përkthyesve, se si janë ato në Rumani? Besoj se një përkthyes nuk mund të jetojë vetëm nga përkthimet, po ashtu sikundër shumica absolute e shkrimtarëve në botë. Çfarë do të ishte ideale për një përkthyes që të kërkonte nga botuesi i tij?

Ashtu është, edhe te ne ka pak shkrimtarë që jetojnë nga shkrimi. As në Rumani këta nuk paguhen në nivelin e duhur, por as nuk nxjerrin para nga xhepi, siç bëjnë shumica e autorëve rumunë. Unë, p.sh., për një libër marr nga *Humanitas* gati më pak se rroga mujore në revistën *Drita*. Megjithatë, pse e bëj, mund të më pyesni. E bëj sepse te ne emri i Kadaresë identifikohet me emrin tim. Dhe sepse, të më falni për mungesë modestie, nuk dua që përthimet e ardhme nga Ismaili, të ndonjë përkthyesi tjetër, të jenë inferiore në krahasim me të miat. Kadareja meriton një bashkëpunëtor rumun të nivelit më të lartë dhe pikë.

Puna e përkthyesit ka shumë të përbashkëta me shkrimtarin. Idealja do të ishte sikur përkthyesi të ishte edhe shkrimtar, do të ishte një fat për lexuesin dhe kulturën botërore. Ju jeni, në fakt, edhe shkrimtar (keni botuar një libër edhe në shqip, me përkthimin e Dionis Bubanit), edhe gazetar po ashtu. Besoj se jeni shkrimtar, përpara se të bëheshit përkthyes. Prandaj edhe përkthimet tuaja janë të një niveli të lartë. Mendoni edhe ju kështu?

Keni plotësisht të drejtë. Kam shkruar letërsi për të rinjtë, kam publikuar proza në disa revista rumune, libra për historinë e Shqipërisë, kam qenë gazetar, kam përkthyer shumë nga letërsia juaj dhe mbi të gjitha, redaktoj edhe tani revistën e komunitetit shqiptar të Rumanisë, *Drita*. Kur isha gjimnazist, kam shkruar edhe poezi. Pra, konsideroj se përkthyesi duhet të jetë edhe vetë shkrimtar. Pa thonjëza. Duke



sjellë në letërsinë rumune veprën e Kadaresë, e fus këtë vepër në letërsinë rumune; në fund të fundit, është vepra ime, krijimi im i papërsëritshëm. Veçse me emrin e atij.

Ende vazhdoni të përktheni nga letërsia shqipe dhe me kalimin e viteve, përkthyesi bëhet edhe më i mirë. Megjithatë, do të doja të dija nëse shihet në horizont ndonjë Dobrescu i ri, cili do ta çojë më tej bashkëpunimin kulturor midis dy vendeve tona?

Përgjigjja ime është se po, ekziston një Dobrescu tjetër, veçse ai tjetri mban fustan. Është një ish-studente rumune në Tiranë që ka disa vjet që përkthen nga letërsia shqipe. Është poeteshë dhe shkruan rumanisht dhe shqip. Mund të them se i plotëson të gjitha kushtet për të qenë një përkthyese shumë e mirë. Emri i saj është Oana Mihaela Glasu.

VEÇANËSIA E JUP KASTRATIT NË STUDIMIN E LETËRSISË ARBËRESHE

nga Prof. Klara Kodra

Jup Kastrati është një nga ato figura studiuesish që sot i gjen rrallë, të cilët shkrinë erudicionin e vet në pasionin për objektin e studiuar dhe që rrokin disa fusha të dijes, duke i shpëtuar nivelit sipërfaqësor dhe duke lënë gjurmët e veta - ndonëse jo në nivel të njëjtë - në secilën prej tyre.

Ka lindur 96 vjet më parë, më 15 prill 1924 në një nga qytetet më të përmendura për kulturë të asaj kohe, në Shkodër. Pikërisht, në qytetin e vet të lindjes, Kastrati do të ndjekë shkolla - që dalloheshin qysh atëherë për nivelin e lartë të përgatitjes së brezit të ri - si gjimnazi klasik dhe liceu real dhe do ta plotësojë kulturën e vet, duke qëndruar madje pak muaj në një lice shkencor në Torino të Italisë. Djali i ri do ta afirmojë veten si një shkencëtar të ardhshëm që në moshën 20-vjeçare me një studim mjaft të pjekur, "Dramatika shqiptare" dhe do ta vazhdojë rrugën e vështirë të shkencës deri në fund jetës së vet.

Jup Kastrati u përket atyre studiuesve që edhe në periudhën skajshmërisht të vështirë të diktaturës, kur synohej ideologjizimi i shkencave shoqërore, janë përpjekur t'i qëndrojnë besnikë objektivitetit shkencor. Në një periudhë kur mbizotëronte metoda sociologjike (që pretendonte të quhej marksiste, por në më të shumtën e rasteve anonte nga sociologjizmi vulgar), studiuesi zgjodhi të përdorte metodën historiko-krahasuese që kishte të përbashkët me metodën sociologjike *historizmin*. Ky i fundit në vetvete përbënte një arritje meqenëse i vinte një lloj dige subjektivizmit të vlerësimeve. Megjithatë, në periudhën e pasluftës, ky tipar u ekzagjerua, duke e shndërruar historinë e letërsisë në një degë të historisë në kuptimin e saj të mirëfilltë, duke lënë pas dore specifikën e letërsisë, pavarësinë e saj relative nga kushtet historike. Gjithashtu, ekzistonte prirja për ta quajtur letërsinë si një degë të ideologjisë, për ta identifikuar me të, duke u bazuar në një tipar të saj objektiv, gjykimin që ajo jep për realitetin, "vizionin për botën", siç e quan Goldmani, tipar që shkëputej nga tipari tjetër themelor, karakteri estetik.

Studiuesi Kastrati, në studimet e veta, ka pasur prirje t'u shmanget këtyre teprimeve që e shkëpusin objektin e shkencës letrare, *letërsinë*, nga tipari i saj thelbësor, *literaliteti* edhe të japë vlerësime për autorët që analizon sa më afër *vlerës* së tyre objektive, vendit të tyre *real* në letërsinë shqiptare.

Do të ndalemi tani në një nga fushat e parapëlqyera prej këtij studiuesi, një degë të letërsisë shqiptare të zhvilluar në Diasporë, por që ruan jo vetëm gjuhën, por problematikën e afërt me atë të atdheut të origjinës. Kjo letërsi kishte vënë në qendër të vëmendjes çështjen e identitetit të kombit shqiptar dhe të çlirimit të tij nga pushtuesi, krahas problematikës që lidhej me vendlindjen, Italinë dhe me gjendjen e vështirë të bashkësisë së tyre si minoritet. Është fjala për letërsinë e Arbëreshëve të Italisë. Kjo letërsi është një dukuri historike tepër e veçantë, meqenëse dëshmon për luftën pesë shekullore të një minoriteti për të mos u asimiluar dhe për të ruajtur gjuhën, zakonet, folklorin e vet. Lartësimi i letërsisë gojore në nivelin e letërsisë së shkruar përbënte një garanci për mbijetesën e kësaj pakice në dhé të huaj dhe një urë lidhëse me atdheun e të parëve. Për frymën shqiptare të saj dëshmon fakti se studiuesit italianë nuk e panë si degë të letërsisë së vet, ndërsa, në të kundërtën, shkenca letrare shqiptare nuk nguroi ta përfshinte në letërsinë mbarëkombëtare.

Studiuesi Kastrati e vlerëson së tepërmi karakterin patriotik të kësaj letërsie, veçanësinë e dialektit në të cilin u shkrua që qëndron disi mënjanë varianteve kryesore të shqipes, toskërishtes dhe gegërishtes, duke pasur megjithatë vlerat e veta të veçanta, e gjithashtu nivelin estetik që arriti letërsia në fjalë, disa vepra të së cilës arritën në rrafsh estetik nivele europiane.

Jup Kastrati parapëlqen ndër autorët arbëreshë më origjinalin dhe më të fuqishmin e tyre, Jeronim de Radën, atë poet që shkëputi letërsinë arbëreshe nga karakteri didaktiko-fetar duke i dhënë dinjitet artistik dhe që gjithashtu përfaqëson letërsinë arbëreshe dhe shqiptare para botës. Këtij autori, Kastrati i kushton një trilogji shkencore monografish, të cilat ngjajnë si tre rrathë koncentrikë, paralelë njëri me tjetrin që vinë duke u zgjeruar:

1) Jeronim de Rada, *Jeta dhe veprat*, Tiranë, 1962;
2) Jeronim de Rada, *Jeta dhe veprat*, Tiranë, 1979;
3) *Studime për de Rad*ën, New York, 2003.

Këto monografi kanë karakter integral, duke përfshirë të dhëna biografike për jetën e autorit dhe duke rrokur të gjitha fushat në të cilat ky personalitet i spikatur u shqua, përveç asaj në të cilën shkëlqeu, poezisë, fushën e dramaturgjisë, të folkloristikës, të gazetarisë, të gjuhësisë, të teorisë së estetikës (ku mbeti i vetmi ndër autorët e Rilindjes) dhe të fundit, por jo më pak të rëndësishme, veprimtarisë politiko-kulturore në dobi të dy vendeve me të cilët qe lidhur, vendlindjes, Italisë dhe atdheut të origjinës, Shqipërisë. Vëmë re disa pika takimi midis autorit të studiuar dhe studiuesit të tij të cilët dalloheshin të dy për shumanshmëri, çka e shtonte edhe më tepër interesimin e pasionuar të shkencëtarit ndaj autorit të analizuar.

Jup Kastrati hyn ndër studiuesit më të shquar deradianë. Përveç analizës shkencore të krijimtarisë së poetit, ai dha ndihmesën e vet me vlerë edhe në përshtatjen e disa veprave të rëndësishme të de Radës në gjuhën e sotme si "Këngët e Milosaos", të cilën e përshtati që më 1956 me titullin "Kangët e Milosaut" dhe veprën madhore të tij, "Skanderbekun e pafan" që do të botohet në përmbledhjen e veprave të autorit arbëresh që pa dritë më 1987 me titullin "Vepra letrare", në tri vëllime. Në këto përshtatje, studiuesi niset nga kriteri i besnikërisë maksimale ndaj origjinalit arbëresh.

Gjithashtu Kastrati do të përkthejë me sukses nga italishtja veprën autobiografike të de Radës "Autobiologjia" (botuar edhe kjo në përmbledhjen e 1987-ës).

Si studiues letrar i de Radës, Kastrati do të përpiqet të zgjidhë disa probleme të krijimtarisë së tij të anashkaluara apo të patrajtuara deri në fund nga dy studiuesit e parë të tij, arbëreshi Mikel Markianoi dhe albanologu italian Vittorio Guartieri. I pari, çuditërisht, ndonëse e zbulon origjinalitetin e rrallë të poetit, ia mohon thelbin romantik, duke parë tek ai vetëm ndikimin nga letërsitë antike greko-romake. Ndikimin e de Radës nga folklori, Markianoi e quan si të metë. Guartieri, përkundrazi, e thekson romantizmin e poetit po nuk arrin të zbulojë ato tipare specifike që e lidhnin atë me romantizmin atipik të letërsisë shqiptare të Rilindjes.

Kastrati e thekson romantizmin e de Radës, duke e parë atë në origjinalitetin e tij, lidhjen e frymës popullore me një lloj elitarizmi që i jep përmasën moderne. Studiuesi ka edhe meritën se e vlerëson një vepër të de Radës të lënë mënjanë nga studiuesit e mëparshëm, si "Rrëfimet e Arbrit", për veçanësitë e saj në rastin e mesazhit dhe të formës. Kastrati i kushtoi vëmendje edhe së vetmes vepër të de Radës në fushën e dramaturgjisë, "Sofonizba", të cilën autori arbëresh e rimerr duke e përpunuar pas variantit jo shumë të goditur të botuar në rininë e tij, "Numidët" (e ribotuar më 1981) dhe zbulon disa nga meritat e saj.

Përveç veprave të botuara lidhur me de Radën dhe ndonjë çështje tjetër të letërsisë arbëreshe, Kastrati shkroi një monografi tejmase të gjerë e të thellë të karakterit ndërdisiplinor, "Studime arbëreshe" (1700 faqe të daktilografuara). Kjo e fundit u përgatit për botim, por nuk doli ende në dritë dhe do t'i pasuronte shumë studimet letrare. Për këtë vepër na vë në dijeni studiuesja kosovare Myrvete Dreshat Baliu, në monografinë e vet kushtuar Jup Kastratit "Enciklopedisti i kërkimeve albanologjike", të botuar nga Shtëpia botuese "Era" më 2014 në Prishtinë. Ajo na flet me imtësi për këtë dorëshkrim që mendojmë se do të mund të vendosej denjësisht në krah të monografisë së fundit kushtuar de Radës "Studime për de Radën", New York 2003, dhe të një monografie të gjerë që i kushtohet Konicës. Tetë kapitujt e kësaj monografie ndërdisiplinore rrokin fushat nga më të ndryshmet, si historinë, etnografinë, folklorin, gjuhësinë, publicistikën dhe bibliografinë. Studiuesja me të drejtë e quan këtë monografi "sintezë të madhe të studimeve arbëreshe". Mendojmë se ajo do të mund të quhej me të drejtë "vepra e jetës e Kastratit".

Jup Kastrati paraqet shembullin e një studiuesi erudit, të pasionuar, të zellshëm e të përkushtuar, që e shkriu jetën e vet për shkencat albanologjike, duke hedhur dritë mbi shumë çështje dhe aspekte të krijimtarisë, të panjohura apo të pastudiuara të autorëve shqiptarë. Ai u dallua në mënyrë të veçantë si studiues i Arbëreshëve të Italisë në përgjithësi dhe i de Radës në veçanti.

STEFAN ÇAPALIKU

Virusi më përndjekë, por unë jam ma i shpejtë.

-nga ditari i Martin Cukut-

vijon nga numri i kaluar

75. E morëm vesh vetëm dy orë ma vonë, kur hyni në dhomë një burrë i shkurtë me maskë e me kapuç infermieri, me një të gjatë po me maskë dhe me kapele polici. Jeni në karantinë, tha i shkurti. Keni ardhë prej Italie, tha i gjati. Po ku jemi këtu, guxova të pyes unë. Këtu jeni në spitalin psikiatrik të Vlorës. Nuk kishim ku t'ju çonim tjetër, prandaj ju kemi sistemuar këtu, si s'ka më mirë, tha i shkurti. Po kur do ta bahen analizat, guxova prapë unë. Ju duhet të rrini njëherë këtu për 14 ditë, mandej do ju çojmë në gjykatë për të marrë dënimin për kalim illegal kufiri dhe mandej, sa u takon analizave, shohim e bëjmë. Po Aminata, ajo zonja që kishim me vete? Aha, atë e kemi çuar nga pavioni i gocave, tha polici i gjatë.

76. Nevzat e kishte emnin i vetmi pacient në atë spital, ai që recitonte me za të naltë poezinë Anës lumenjve të Qemal Stafës. Mu më tingëllon si ndonjë përkthim i poezive të D'Annunzios, tha Don Tarcisio dhe i vu veshin Nevzatit. Ndërkaq, Abdelkabiri dhe Carixo rrinin në një cep të trembun. Unë e nxora Nevzatin mënjanë, i dhashë pak djathë nga ai me krypë i Abdelkabirit, dhe e pyeta sesi dilet prej këndej. Duhet pritë sa të vijë treni, tha Nevzati. Unë lëviz vetëm me tren, vazhdoi ai. Me tren?! Treni?! Boooo, çfarë ide gjeniale. Duhet provu treni. Nuk di pse kam idenë që vetëm treni funksionon në këtë vend.

77. Martin! Më thirri Abdelkabiri dhe më shtërngoi butë krahun. Ne s'mund të ikim prej këtu pa marrë me vete edhe Aminatën, shtoi ai dhe më shikoi me një palë sy të langshëm, si të kishin qenë të mbushun me lotë. Pashë dashuni në ata sy. Nuk di të them nëse ishte thjesht dashuni njerëzore apo prej atij llojit tjetër, por me randësi ishte që pashë dashuni. Po si ta kërkonim?! Ku ta gjenim Aminatën?! Kujt t'ia lypnim?! Mu kujtu baba i shkretë kur thoshte: Lype, s'ta japin; merre, se s'thonë gja. Don Tarcisio kërkoi t'ia përktheja shprehjen, por nuk kishte burrë nane. Kam hall mos m'i ka mbetë hatri.

78. Operacionin për çlirimin e Aminatës e thirrëm Covid-23, në kujtim të natës së 23 Marsit. Operacionin e udhëheq Nevzati, qe gabimisht pak ma sipër e quajtëm të marrë. Nevzati s'është aspak i marrë. Ai qenka shti si i marrë në kohën kur na pa neve brenda. Na ka pandehë për kontroll. Ai thjesht banon në spital, ngaqë ka lanë shpinë e vet në kumar. Nevzati iu bashkua grupit, mbasiqë dha idenë e mrekullueshme të arratisjes me tren. Nevzati i njeh të gjithë mashinistët e Vlorës. Njanit syresh i ka pasë fitu lokomotivën në kumar. Me lokomotivën e Nevzatit do nisena në drejtim të Fierit, mandej Rrogozhinës, Durrësit e deri sa të arrijmë në Tiranë.

79. Aminatën e gjetëm kollaj, sapo dolëm nga ana tjetër e godinës. E shkreta, rrinte ulë në një stol rrethu prej dy tipash, që dukeshin si personel mjeksor e që po i propozonin ta çonin në Itali. Ma qafderri prej tyne i premtonte edhe dokumenta pune, kurse ai ma pak qafderri i thoshte se mund të merrte edhe ndonjë shoqe me vete po deshi. Përpiqeshin të merreshin vesh në italisht. Aminata, kur dëgjonte emnin e Italisë, përpiqej tu bante me shenja se ajo prej andej sapo kishte ardhë. Atëherë u desh ndërhymja e rreptë e Nevzatit që të zgjidhej kjo punë. Aminata i futi sërish krahun Abdelkabirit. Tashma dukej sheshit se ata kishin ra në dashuni.

80. Pritëm që të mbaronte orari i lëvizjes së kambësorve dhe, tamam diku nga ora 2 e drekës, u nisëm kambadorazi për te lokomotiva. Nevzati na printe. Habitesha me entuziazmin dhe gatishmërinë e tij për të na ndihmu. Rrugës gjeta rastin ta pyes me marifet se për ku ishte nisë. Ai më tha, me një ton aspak miqsor, se kishte vendosë të na e jepte lokomotivën me qira. Ju kam miq, tha ai, prandaj do paguani vetëm naftën dhe mashinistin. Po të mos ishit miqtë e mi, do ju duhesh të paguanit edhe shefin e stacionit. O Zot, falemnderës! Për fatin tonë të mirë, lokomotivën nuk e gjetëm. Se kush e kishte marrë pesë minuta para se të arrinim ne. Me randësi asht që janë shinat, tha Calixto.

81. Diku mbas orës 6 mbasdite kemi arritë, pa i ra kujt në sy, deri te një katund që thirret Novoselë. Aty Don Tarcisio dha urdhën të ndalemi, të hamë darkë e të flemë. Për fat, na ka mbetë edhe do djathë nga ai i Abdelkabirit. Pak bukë e kemi vjedhë te spitali, kështu që s'ka ma mirë. Jemi lodhë, por do Zoti e nuk na kapin. Simbas një llogarie që ka ba Don Tarcisio, do na duhen edhe 4-5 ditë me sosë deri në Tiranë. Tamam sapo u shtrum me hangër, veç kur po na afrohen dy vllazën nga fshati Tre Vllazën, me një shishe raki. Le të pijmë, vëllezër, pas vendimit të sotëm në Bruksel për çeljen e negociatave të BE me Shqipërinë! Vetë Ministrja për Marrëdhëniet me Evropën e ka thanë sot se Shqipëria është në momentin më të mirë historik në raport me të ardhmen evropiane. Me rob shpije, të pijmë e të bëhemi bythë për shëndetin e saj!

82. Ata dy vllaznit nga fshati Tre Vllazën e pinin me dolli. S'kishte burrë nane të shkapej kollaj prej tyne. Njani syresh shkoi në fshat dhe solli edhe ca meze. Ullinj, për shembull. Tjetri, ma i madhi, e pyeti Don Tarcision se kë kishte në shpi. Askënd, tha Don Tarcisio, jam prift. E morëm vesh se je prift, o të qifja udhët, por po të pyesim se kë ke në shtëpi, që të ngremë dolli për ta, ngulmoi ai. Ja, ta ngremë për nënën! E ke nënën? E kam, tha Don Tarcisio, dhe e ngritëm të gjithë me fund për nanën e priftit. E njajta gja edhe për të atin, edhe pse Don Tarcisio nxitoi të thoshte që nuk e kishte babën. Pas priftit, në shenjë respekti u kthyen nga Aminata, e vetmja femën në atë livadh. Aminata tashti kishte pasë dyrnjanë e robve në shpi. Aq shumë rob, sa u bamë të gjithë mut me dolli...

83. U zgjum prej gjumi ndër do dhoma me tavane të naltë, si të ishim në sinagogë. Mesa duket, dikush na kish tërheqë zvarrë e na kish futë në shpinë e tre vllazënve. Duhet të ruhemi nga virusi, u ndëgju zani i një gruje, që e gërvishi napën e mëngjesit si të ishte me thikë. Unë gjendesha i shtrimë në dyshemenë prej dërrase të dhomës. Calixto gjithashtu. Vetëm Don Tarcisio flinte mbi të vetmin shtrat që kishte dhoma. E kishin respektu. Abdelkabirin me Aminatën nuk i shihja kund. Thu t'i kenë lanë në livadh të shkretët?! E ndërkohë që po mendoja këto, hyni në dhomë ajo gruja me zanin si thikë e me një shkop fshese në dorë. Dilni që aty! Dilni që aty, ju thashë! Ua këta! S'ju vjen turp, s'ju vjen! Pa dilni, dilni! Dhe e nxori me pahir çiftin nga ndënkrevati i Don Tarcisios. Duhet të ruhemi nga virusi, ju them! Dhe përplasi me aq të madhe derën, sa zgjoi nga gjumi edhe Dom Tarcision.

84. E enjte, 26 mars 2020. Nisëm rrugën shtigjeve, nga fshati Trevllazën, në kambë për në Bubullimë të Lushnjes. Kund nja 38 km. Nuk e di a mund të sosim nga darka. Ditë e ftohtë, e vrantë dhe me cikërrima shiu. Gjithashtu, nuk e di tamam si ndodhi, por diku në mes të rrugës na u shfaq prapë ajo biondja që patëm taku në Itali, ajo që mbeste shtatzanë sa herë që shkonte me pi kafe në milet. Du të rrëfehem, i tha ajo në italisht Don Tarcisios. Mirë, ia priti Don Tarcisio, dhe u kthy nga ne: uluni e më pritni për pesë minuta sa ta rrëfej zonjushën. Veç kur po të hidhet dhe të flasë vetë zonjusha: Jo Don! Të lutem. Nuk asht punë pesë minutash. Kishte me u dashtë e gjithë dita dhe nuk di a mund të mbarojmë nga darka. Atëbotë Don Tarcisio na la celularin e vet, sic u lihet fëmijve një lojë për me i habitë. Ndërkaq, vrisja mendjen se ku e kisha pa atë fëtyrë.

85. Ne s'na mbeti tjetër veç me pritë. Abdelkabiri me Aminatën dolën një gjiro andej nga mullarët, kurse unë me Calixton u ulëm të lexonim lajmet te celulari i Don Tarcisios. Calixto kishte ba përparime të mëdha në shqip, por jo deri në atë shkallë sa me kuptu se pse ishte rrëzu një natë ma parë qeveria e Albin Kurtit në Kosovë. Këtë s'e merrja vesh as unë që medemek dija shqip, e jo ma Calixto. Calixto mandej u interesu për parashikimin e motit dhe u mërzit shumë kur pa se edhe java në vijim kishte me qenë me mot të keq e temperatura të ulëta. E meqenëse Don Tarcisio po vononte në rrëfim, Calixto desh me ditë edhe për numrin e të prekunve nga Covid-19 këtu në Shqipni dhe numrin e viktimave. Kështu e ka kjo punë, tha Calixto, revolucioni do ketë edhe viktimat e veta.

86. Veç një tabelë andej matanë rrugës tregonte se ishim diku afër katundit Besnik i Madh. Pritëm sa u shkepëm. Kaq shumë paska pasë me i thanë ajo biondja Don Tarcisios, sa nuk di me ju diftu. Me sa dukej, Don Tarcisio s'e kishte ndër mend me ardhë. Dhe me të vertetë. Ai kishte nisë një fëmijë me një copë pusull dhe me një strajcë me ushqime dhe një shishe raki. Në atë pusull thuhej: Të dashtun. Këtu në fshatin Besnik i Madh ka shumë zonja që kërkojnë të rrëfehen. Detyra nuk më lejon që të mos u shërbej njerëzve. Mandej ndjehet edhe një zell i madh për t'u konvertu. Mbetem i juji, Tarcisio. Kështu, mbas ikjes së Don Tarcisios, Abdelkabiri, Aminata dhe Calixto janë shtërngu edhe ma shummë rreth meje. Nuk di si t'ua baj hallin.

87. Nuk di si ta ndjej veten mbas ikjes së Don Tarcisios, të braktisun apo të lehtësum. Ishin dy ndjesi të kundërta, por edhe jo fort. Abdelkabiri me Aminatën kishin fillu të ecnin gjithmonë e ma mbrapa e gjithmonë e ma ngjitë me njani-tjetrin. Me Calixton po e kuptoja kilometër mbas kilometri se nuk më lidhte thuajse asgja, përveç rrugës. S'e kisha imagjinu kaq të trishtë këtë kthim. Kishim kapërcye Lushnjën bashkë me do vende që më shtinin tmerrin, si Savër, Grabian, etj.* Në darkë vonë, ndoshta andej nga Kavaja, majë një kodre prej nga shihej deti e përtej detit mundeshe me imagjinu Italinë e gjorë, u çu një erë e fortë, e marrë, e ngrohtë, e përmblodhi gjithçka kisha përrreth o me njena-tjetren ose me vetveten. E në atë gjiratore të kuqërreme prej muzgut të bamë nga dielli në perëndim, pashë sesi u banë bashkë Abdelkabiri me Aminatën dhe fluturun si një zog i vetëm, elegant e mirënjohës, deri sa u zhdukën një Zot e di se nga...

88. Ma në fund, ndeshëm në një bamirës. Shoferi i makinës së plehut, që kalonte andej pari, qe një kavajas që e kisha pasë në ushtri. E njohëm menjëherë njani-tjetrin. Këtu tek ne është bërë më keq se në Itali, tha ai. S'keni bërë hiç mirë që keni ardhur, vazhdoi. Tash kapni ndonjë vend në rimorkio, se këtu në kabinë nuk mund t'ju fus. Asht pak pis, por s'kemi çka i bajmë. Hypëm të dy në makinën e plehut, që për çudi nuk mbante erë. Në fakt, e pata dëgju që në Itali se shenja e parë e sëmundjes ishte humbja e nuhatjes. Po nejse. Ai na jepte herë mbas here muhabet. Ne kaq shumë na dhimbnin kambët, sa do kishim qenë të knaqun me pasë hypë edhe në makinë të vdekunish, e jo ma të plehut. Calixto nxori prapë të lexonte Manualin e luftës gurreile të Fidel Castros, kurse unë vazhdova muhabetin me shokun e vjetër. Se i kishim fjalët ndryshe, atëhere kur rrëzuam komunizmin. Se ne kavajsit me ju shkodranët nuk ua sollëm demokracinë të tallen këta me ne. Do t'ju çoj krejt afër Tiranës. Në Kashar. Ma afër s'mundem. Kështu pakashumë dëgjova e më kaploi gjumi.

89. Veç kur zbritëm nga makina e plehut në Kashar, mbas gjithë atij gjumi të thellë, ra fjala për zhdukjen në mënyrë misterioze të Abdelkabirit dhe Aminatës. Calixto mbronte me vendosmëri tezën se ata nuk kanë humbë. Asgja nuk humbet, çdo gja transformohet, tha ai. Madje ai vazhdoi me mësimin tjetër të Materializmit Dialektik, në bazë të të cilit transformimi i atyne të dyve në një zog të vetëm, nuk na paska qenë rastësi, por domosdoshmëni. Dhe duke e trajtu thellësisht këtë temë, ne arritëm në dy pika kryesore: pika e parë, se domosdoshmëria e çan rrugën përmes rastësisë dhe, pika e dytë, nga ana e pasme e gardhit të Ministrisë së Jashtme, në Tiranë. Për hirë të së vërtetës, mua kjo pika e dytë më interesonte ma tepër. Kështu që lashë Calixton aty dhe u turra për nga rruga që do më çonte te shpija ime, në Shkodër.

90. E t'u nisa fluturim për Shkodër. Nuk e di nga më erdhi ai hov. Por ma së shumti mendoj se u hepova kur mu vu nga mbrapa një polic. Sepse, sapo u përqafa me Calixton e mora me dalë në xhade, buzë Lanës, më dolën përpara jo një, por dy policë. Një barkmadh dhe një barkpetë, që më kërkun lejen e ardhun në celularin tim nga numri 55155. Unë desha me folë e me i sqaru se nuk kam celular, por mandej i thashë vedit: futja vrapit se kush rri e merret me ta. Dhe kështu bana. Ia mbusha andej nga Ura e Tabakëve. Ai barkmadhi, si ma i shpejtë, m'u vu mbrapa. Dhe kështu, unë nuk e di se nga më erdhi ajo fuqi, por fillimisht ndjeva një zbraztësi në bark e mandej në gjoks, e mandej mu hapën krahët si të ishin penda pate dhe, tamam në majë të urës së gurtë, kur barkmadhi ende nuk ishte ngjitë, mu dha një hov, një e shtyme prej mbrapa, gja që s'kish ba kurrë vaki, e tu ngrita në ajër, si t'më kishin kapë shtatëqind dreqën, e fluturova. Tamam mbi selinë e PD më iku frika e mu duk vetja si dallëndyshe. O Zot! Të fluturosh, çfarë kënaqësie! Kurse mbi seli të PS erdhën e m'u kujtun vargjet e poezisë së famshme të Hilë Mosit ose të Daut Boriçit, nuk më kujtohet mirë, Shko dallëndyshe:

Udha e mbarë, se erdh prendvera,
shko dallendyshe tue fluturue,
prej Misirit n'dhena tjera
fusha e male tue kërkue;
n'Shqypni shko, pra, fluturim,
shko në Shkodër, n'gjytet tim!

91. Shyqyr që më kishte falë Zoti dallëndyshe mashkull. Kisha idenë se gjithmonë më kishte pëlqy një dallëndyshe me emnin Martin. Emni im më dukej se e bante shumë seksi një dallëndyshe. Këto pakashumë po mendoja, tek fluturoja për Fushë-Krujë. Vendi dukej i shkretë nga lart dhe kishte shumë pak insekte fluturuese për ushqim. Mesa dukej i kishin davaritë ca fabrika e çimentoje dhe furra gëlqereje të hapuna në mal. Fabrikat ngjanin si tokëza, kurse furrat e gëlqeres si të vrame lije në trup të malit. Desh iu afrova një çifti që kish dalë te oborri i shpisë së vet. Burri mbante në dorë një spatë. Por, jo. Mos u ban budallë, i thashë vetes, se me një dallëndyshe nuk vjen pranvera. Dhe u lëshova pikiadë në drejtim të Mamurrasit, si të isha dallëndyshja e parë. Pashë burra nëpër rrugë, shumë burra, dhe gati mu neverit zgjedhja. Vetëm dy femna, diku në një qoshe, që dukeshin të trembuna si të ishin zogj dallëndysheje. Por s'kishte gja ma shumë me pa, se aq. Në dalje të qytezës, dikush po shiste raki. Dy burra të tjerë u ndalën dhe e pyetën atë zotninë e parë për çmimin. U dëgju vetëm një ofshamë: Shtrenjtë! Shumë shtrenjtë... si me qenë qumësht dallëndysheje. Atëherë unë preka cicat e mia.

92. Muzgu i datës 31 Mars 2020 më zu diku matanë Lezhës. Tek fluturoja mbi Lezhë, mu kujtu një tjetër shok ushtrie. Ia dija madje edhe shpinë. Iu afrova nga sipër dhe e pashë. Ishte ai, Tuku. Ia njoha shpatullat e gjana dhe kryet shpatuk. Kishte lanë mustakë dhe ishte thinjë. Nanën e kishte gjallë. Ashtu të plakun e të bame garravaç te një stol në qoshe të oborrit. Rrinte vetëm dhe diçka pëshpëriste. Ndoshta lutej. E ç'më kapi një mall! Iu afrova edhe ma shumë dhe mbajta ekuilibrin mbi një tel teshash, tamam mbi krye të tij. Tuku po çante dru. Tuk, e thirra. Tuku çoi paksa kryet, më pa në sy dhe buzëqeshi. Nanë, thirri ai me të madhe, po vjen pranvera. Qe ku na erdh për vizitë edhe dallëndyshja e parë. Nana e vet mezi e çoi kryet e më hodhi një ledhatim si mikeshë e kahershme. Tuku vazhdoi me ça dru. Tuk! Jam Martini. Martin Cuku! A po kujtohesh? Martini që patëm ikë pa leje kur lunte futboll Flamurtari me Vllazninë. A të kujtohet çfarë gallate?! Tuku çoi edhe njëherë kryet dhe shikoi përreth. Nanë! Po çmendem nanë. Dëgjoj zane. Po më lun mendsh kjo mut karantine. Dhe çoi spatën për me i ra një trupi, kur tuni i saj erdh e u përplas tanë forcën për telin ku kisha vu kambët. E u çova vrik fluturim edhe një herë ashtu i turbullum. Fluturova edhe pak me të marruna mendsh e të vjella prej goditjes, derisa zuna strehë në Kukël, te shpija e poetit Dom Ndre Ukgjini.

93. Ka dy arsye që s'mund të hyj sot në Shkodër: e para, se ka çu Zoti borë, dhe e dyta, se sot asht 1 prilli, dita e rrenave. E ç'kuptim do kishte të dukej nëpër qytet një dallëndsyhe nëpër borë? Do tingëllonte absurde! Do thonin se asht rrenë. Nuk do ta besonte njeri as ekzistencën time. Nga ana tjetër, kam me e pasë ngusht edhe për ushqim sot. Gjithçka po mbulohet me të bardhë përreth meje. Hej more Zot! Nuk e kuptoj se çka ndodhi me mu që u shndërrova në zog, e aq ma tepër në dallëndyshe. Çka nuk të ban frika! Nuk asht tamam frika, frika ndaj një polici barkmadh. Unë mendoj se duhet të ketë qenë ma shumë marrja, turpi, sesa frika. Me ba gjithë atë rrugë në kambë nga Cinquantina e Italisë e deri në Tiranë, e aty mandej me dalë e me të kapë një polic prej Smukthinet, e me të futë me zori në Quarantina?! Po jo more zotni! Punë që s'bahet! Prandaj Zoti mëshirmadh më ktheu në zog. Falemnderës prej Tij! Por si i bahet tash për me u kthye prapë ashtu si isha? Domethanë, me u ba njeri?

94. Nuk prita me i dhanë përgjigje pyetjes sesi mund të bahesha prapë njeri, por, ashtu dallëndyshë siç isha, pa pritë të shkrihej bora dhe me krahë akull prej të ftohtit, u lëshova vrik e për Shkodër. Në atë vend që e njoh përmendësh si zog e si njeri. Ja, qe edhe rrugica ime. Dera e oborrit. Mbas saj një shteg i ngushtë, i shtrum në kalldram. Anash lule. Paskan çelë vjollcat, zymbylat, sh'jozefat, narcizet, tulipanat, e përtej mbi bar edhe luledelet. Edhe pak e drita e Zotit po mekej. Iu afrova dritares së dhomës së ndenjes e u mbështeta te hekurat e saj. Atje mbrendë im bir i ulun para një kompjuteri, në ekranin e të cilit dukej një fëtyrë gruje, që thërriste me të madhe se si krijohen shprehitë për ruajtjen e mjedisit. Duhej të ishte mësusja e matematikës. Im bir, sallaks, përpiqej të mbante shënime mbi një fletore dhe në dorën e djathtë, poshtë kompjuterit, kishte celularin. Ime shoqe shihej si siluetë në fund, te kandi i gatimit. Me siguri që po bante supen e vet me barishte. Të kërcisja me sqep mbi xham e t'i thoja djalit se jam baba, më erdhi zor. Mandej, nuk dija edhe si do sillej ime shoqe kur të merrte vesh se kam ardhë direkt e nga Italia, prandaj, ik i thashë vetes. Puthi të dy me sy, ruj distancën sociale, dhe shko e struku diku, në pritje të kohnave ma të mira...

Fund

/©/stefan /çapaliku/tiranë/mars/2020/

* Vende internimesh në kohën e komunizmit.

DITËT E NJEJTA

cikël poetik nga

Manjola Brahaj

QYTETI

Lkurë e shndritshme flet
se poshtë plasave âsht nji tokë e errët hijesh,
se poshtë zien nji vrushkull i ethshëm pavetëdijesh,
ndihet nji qytet që fle me ninulla paragjykimesh,
të fshehuna nën shtresa të randa zgërdhimjesh.

Jeta ndrydhet e rrmyhet prej myknash e zjermish,
i hupë ftyra, i hupin andrrat i dalin sysh,
të bahet se ndien tinguj të pakuptimtë mesjetash
t'palueme,
që thuren me fjalë të vdekuna, të vonueme.

L`kura vazhdon me shndërritë
qytetit i shihen bedenat e kalbun,
çudshëm vaj nuk ka veç kangë shkëlqimtare për ditë,
të kërcyeme prej kambësh që ua mbajnë dredhitë.

Âsht nji valle e çmendun që të merr përpara vetit,
âsht nji ankth toke që të tjetërson,
âsht vetja e shkelun për hir të tjetrit,
që ban sikur jeton.

DITËT E NJEJTA

I kam frikë ditët e njejta
më drithnojnë shpirtin,
janë si pikat e nji çatie të prishun
që pikon me ritmin e njejtë dhe e lagë mbrendinë,
e shkatërron edhe çatinë;
pangurrueshëm derisa prek qensinë,
kambëngulshëm deri në kalbje,
si nji udhëtim pa ardhje,
si nji viciozitet pa rrugëdalje.

Dhe qenia bahet si baltë e ngurosun në ne,
formësohet për mos me i ngja as vetes,
ditët e njejta na e shkurtojnë udhën drejt vdekjes.
Janë të prekshme por të pajetueme thellësisht,
të varuna në qafën e ditëve tona,
si nji fill rruzash identike,
në kërkim të nji përsosmënie boshe.

Ditët e ngjashme janë po ashtu frikë,
mundohem qosheve të ditës me u mshehë e prej tyne
me ikë,
ato janë ma të rrezikshme
me praninë e tyne të papërcaktueme qartë,
zgjojnë prej pluhnit kujtime të padëshirueme,
janë kopje të shëmtueme të nji të shkumje të paje-
tume,
janë andrra të pa andrrueme në ikje,
që u hapin rrugë fantazmave të fjalëve që dukeshin të
vorrosuna,
simotrave të tyne antike.

Edhe ato pikojnë
në qenien tonë
me hapin e tyne shkelin mbi kohën,
në kryet tonë pikë pikë
tue na shndërrue në diçka tjetër,
as vet pa e ditë.

MBRENDA NESH

Mbrenda nesh asht nji det i errët
e në atë det endet nji varkë,
përplaset anëembanë brigjeve të tij,
e mbrenda saj prehen;
nji pikturë e lashtë imazhesh të pashpjegueme,
nji thes kockash të thyeme e të kalakryqueme,
nji violinë e ndryshkun e mbushun rrast me tinguj,
të ndrymë mbrenda vetes,
nji arkë plot me andrra për me i ba ballë jetës.

Mbrenda nesh asht nji det,
nji det i pa fund,
që herë flen
e herë na shkund.

***

Bjen shi.
Dhe tingujt përtej dritares
më shfaqin fantazmat e krejt dritareve
prej të cilave kam vështrue shiun.

KUJTIMET

Kujtimet zgjatin sytë
natën përtej dritares.

Në pyje të largta rrëzohen pemë,
pa ua ndie kush zhurmën,
ka çaste në të cilat kisha dashtë me e dashtë edhe
turmën...

Kujtimet zgjasin duert
ditën përtej derës.

Në udhë të largta enden zogj,
pa ua ndie kush kangën,
ka çaste në të cilat kisha dashtë me e dashtë veç
nanën.



I DASHURI I SAJ I PARË

tregim nga

Vath Koreshi

Ndoshta nga që ishte pranverë!

"Ndoshta ngaqë është kjo stinë" tha Çiljeta me vete dhe nuk diti se çfarë të thoshte tjetër. I qe kujtuar i dashuri i saj i parë.

"Nuk di se çfarë" tha dhe ndjeu se e shtrëngoi një brengë brenda kraharorit.

Kishte kohë që s'kishte bërë ndonjë udhëtim larg shtëpisë të të shoqit dhe tani, duke soditur natyrën që dilte nga dimri, i zgjohej në zemër një si mall që nuk e kishte provuar ndonjëherë. I vinin nga larg ca gjëra të harruara kushedi qysh kur. Ndoshta nga afshet e pranverës, tha. I bëhej sikur ndjente erën e luleve të para dhe të barit të ri, që buiste në fushat e kredhura në mjegulla. I shoqi, mbështetur pas sediles së veturës, dremiste dhe herë-herë nxirrte ndonjë gërhimë të lehtë.

Po i grisej një si perde. Atje prapa ish diçka që nuk kish qenë e mundur ta harronte.

Kur mbërritën, ndjeu se asgjë nuk mund të fshihej më. Taksinë e lanë në qendër, mbasi i shoqi kishte dashur ta bënin në këmbë rrugën gjer në shtëpinë e prindëve të saj dhe, duke ecur krah njëri-tjetrit, Çiljeta përpiqej të gënjehej pas gjërash të kota. Shihte pullazët që nxirrnin krye mbi drurët e kopshtijeve, shtëpitë e vogla, përroin që rridhte nën këmbët e urës së vjetër...

Në shtëpi i pritën krahëhapur, por ajo nuk u ndje më e lehtësuar. Aty qe më keq. Aty pranë ishte shtëpia e atij, e të dashurit të saj të parë.

Kishin kaluar dy vjet, që kur e kishin përcjellë nuse dhe, gjatë gjithë asaj kohe, veç disa ditëve pas martesës, nuk kishte ardhur më aty. Kjo qoftë ngaqë e ëma dhe i jati i venin shpesh në Tiranë, qoftë ngaqë i shoqi ishte i mbytur në punë. Kishte për të mbrojtur një disertacion dhe kjo i merrte gjithë kohën. Por edhe ajo nuk kishte dashur të vinte. Kishte dashur të qëndronte larg që të harronte.

Ditët e para të ardhjes së saj te prindët kaluan me atë atmosferën e gëzuar, që zotëron në shtëpitë ku ka njerëz të dashur. Çiljeta mundohej të harrohej mbas çdo gjëje të vatrës së vjetër të familjes dhe bënte kujdes të mos i hidhte sytë nga shtëpia fqinje e të dashurit të saj të parë. Shtëpia e tij ndahej me një mur dhe nga një kangjellë, që ngrihej deri lart. Ai ishte atje, mbas murit dhe mbas kangjellës. Ishte nën çatinë që ngrihej me një kulm të lartë dhe me një fluger, që vërtitej nga era. Ishte një shteg mes avllive, që të çonte atje, një hapësirë nëpërmjet të cilës hynin e dilnin, kur familjet kishin marrëdhënie të mira. Tashti në shteg kish mbirë bari. Çiljeta s'e mënjanonte dot dëshirën që e ndillte drejt atij shtegu. Ditë me ditë dhe nisën ta shtynin këmbët për nga ajo anë. E bëri zakon të vinte për ditë aty, kur babai dhe i shoqi luanin shah dhe e ëma merrej me përgatitjen e drekës. Por nuk kishte arritur të marrë kurrfarë shenje ku ndodhej ai, i dashuri i saj i parë. Nuk kish arritur asnjëherë ta shihte në hapësirat e oborrit matanë. Nuk kish arritur të shohë as edhe ndonjë të familjes së tij. E ëma punonte ende në një zyrë dhe shkonte në punë në mëngjes e mbasdreke, babai ishte inxhinjer në puset e naftës dhe vinte rrallë. Kurse ai ish mësues, por shumë i zënë, mbasi kish në shkollë edhe një klasë sportive, ndërsa mbasditeve kishte praktikat me skuadrën e futbollit. Haja, shoqja e fëminisë, kishte gjetur rastin dhe ia kishte treguar si enkas të gjitha këto. Haja kish marrë shkas t'i thosh diçka, sepse vetë atë e kishte marrë malli për atë kohë, kur shkonin dhe e shihnin, kur ai luante futboll në stadium me skuadrën e qytetit. Ai kishte qenë idhulli i tyre.

Pasi hanin mëngjesin dhe pinin kafenë, dhe i shoqi niste e luante shah me babanë, i cili kishte marrë, me rastin e ardhjes së tyre, disa ditë nga leja e zakonshme, pasi mamaja u futej përgatitjeve të drekës dhe në shtëpi asnjeri nuk e kishte mendjen tek ajo, ajo vidhej dhe vërtitej rreth atij shtegu. Gati po e lodhte kjo gjë, sepse nga shtëpia matanë, si zakonisht, nuk kapte asnjë shenjë. Mundet që i kishin grumbulluar në hotel gjithë sportistët, thosh me mendje, ngaqë mund të kishin ndonjë ndeshje të rëndësishme.

Një të shtunë, nga ato më të zhurmshmet në shtëpi, se vinte tezja që nisej për te i biri në Durrës, vinte Haja me dy shoqe ngaqë e kishin pushim, pra një të shtunë, para se të plaste poterja e njerëzve që vinin, Çiljeta ndjeu që mbërriti gjer te veshët e saj zëri i tij i njohur! Ai po i thoshte nënës së tij se nuk do të kthehej atë drekë në shtëpi, as në darkë nuk do të kthehej, pasi do të niseshin me skuadrën për një ndeshje jashtë qytetit. Çiljeta mbërriti te shtegu dhe po shikonte nga ai. Ishte çasti kur ai po ngrinte në sup çantën me rrobat e sportit, kështuqë dalloi trikon e kuqe të saj. Iu shua sakaq buzagazi. Iu hutua vështrimi, por vetëm për një grimëherë. I hoqi sytë nga ajo dhe shkoi drejt portës.

Atëhere Çiljeta nuk mundi të përmbahej dhe thirri:

-Fredi!

I doli padashur kjo thirrmë.

Fredi ktheu sytë për një çast nga ajo, pa si në bosh, pastaj hapi kanatën e portës. Në çast sikur ndërroi mend. Teksa kishte dalë matanë kanatës e po bëhej gati ta mbyllte, ndali. Dukej dora e tij, që ishte kapur pas dërrasës. Çiljeta pati shpresë se ajo dorë nuk do ta linte atë të ikte. Ishte dora që e donte aq shumë. Mbante mend se si ishte dridhur ajo, kur i kishte përkëdhelur për herë të parë fytyrën dhe e kishte tërhequr për ta puthur. Kjo kishte ndodhur në një mbrëmje të largët, në një terrmenatë të mbushur me ithtërën e pranverës që afrohej. Ishte ajo stinë, kur qielli bëhet aq i kaltër dhe mbushet me aq shumë fistone resh të bardha, që ngjajnë si vello nusërie ndehur në horizont. Kishte ndodhur në atë kohë, kur tundeshin degët e mimozave nën erërat e ngrohta të jugut dhe kur ndjente se si i çelej diçka e bukur dhe mallëngjyese në zemër. Fredi, mbas asaj nate aq të bukur që e kish puthur, kishte gjetur një pjesë, e kishte kopjuar dhe ia kish dhënë, duke i thënë se pak rëndësi kishte kush e kish shkruar. Mendoi se i kam shkruar unë, i kishte thënë, se edhe unë fjalë të tilla dua të të them, por nuk mundem, nuk di. Ishin fjalë për sytë e saj që, siç thoshte letra që i kishte dhënë Fredi, të kujtonin gjallërinë e pranverës, ëmbëlsinë e verës, trishtimin e vjeshtës dhe brengën e dimrit. Sepse ata ishin më të kaltër se qielli, më të pastër se drita, më të thellë se deti, sepse kur qeshnin ata s'kishe pse e doje bukurinë e qiejve dhe se kur qanin ata qante edhe moti në një ditë të bukur maji...

Ah, tha me vete Çiljeta dhe i kaloi një drithërimë nëpër shpirt nga përjetimi i atij çasti. Ishte shumë e troditur tashmë që shikonte vetëm dorën e tij. I bëhej sikur frynte një stuhi, që mbartte aq brengë dhe aq dëshpërim. Fredi, si ndenji edhe disa çaste matanë kanatës së portës, e tërhoqi atë dhe e mbylli mbas vetes. Çiljeta ndjeu thellë në shpirt gjëmime, që paralajmëronin afrimin e një shtrëngate. Ajo do të shpërthente nga çasti në çast; dhe vërtet, nuk vonoi dhe në një qosh të zemrës nisi t'i bjerë një shi i rëndë e i hidhur. Rrëketë e tij derdheshin përmes gishtërinjëve të saj; me sytë tërë lotë ajo shihte shtegun dhe oborrin matanë, si të kredhur në fundin e një uji që valonte.

Dy vjet më parë, e ëma e Çiljetës, Lina, u gjend shumë e shqetësuar. Njera nga mbesat, që punonte në rrobaqepësi, i kishte thënë se Çiljetës po i dilnin fjalë me komshiun e tyre, Fredin. Asaj i ra si bombë zbulimi që i bëri mbesa dhe ca nga kjo, ca nga një ëndërr e vjetër, për t'i dhënë së bijës një burrë të zgjedhur, u bë pikë e vrer. Me shugullima e me tmerrin që e pushtoi, ndërmori një udhëtim, së bashku me Çiljetën, për te një kushërira e saj në Tiranë. Ishte fund korriku, Çiljeta kish bërë dy javë plazh mbas mbarimit të gjimnazit, kishin qenë familjarisht në një shtëpi private në Shkozet, dhe atje asaj i kish prirë shumë. Qe nxirë nga dielli dhe i ishte mbushur trupi, qe bërë një vajzë që me të vërtetë të tralliste mendjen. Lina ishte e bindur se vajzën e saj mund ta lakmonte shumëkush, por ajo ia kish vënë synë një dhëndërri, që banonte në një shtëpi me të kushërirën e saj në Tiranë, në një ndërtesë tip vile dykatëshe. Mbas vdekjes të së jëmës, ai jetonte vetëm në tri dhomat e katit të sipërm. Ishte një djalë rreth të tridhjetave dhe punonte në Minisrti, ishte inxhinier ujrash, shumë i zoti, thoshnin. I sjellshëm, i qeshur dhe i vëmendshëm, ai të bënte për vete që në çastet e para të njohjes. Çiljeta i tërhoqi vëmendjen atij që në çastin e parë, kur ato, ëmë e bijë, hynë në oborrin e vogël me dy nespulla dhe tri-katër gëmusha trëndafilash që ishin aty. Inxhinieri kishte hipur mbi një palë shkallë bojaxhiu dhe priste me gërshërë degët e harlisura. Lina gati thirri nga gëzimi që e shihte, kushërira doli sakaq dhe u puthën e u përqafuan, inxhinjeri zbriti nga shkallët dhe erdhi e i takoi, kështuqë gjithçka ndodhte si jo më mirë. Meqë ishte buzëmbrëmjeje dhe aty në oborr bënte fresk, kushërira, që ishte një grua e zgjuar dhe e shkathët, nxorri një tavolinë dhe disa karrige aty, i uli sipas radhës dhe vuri xhezven të bënte kafetë. Sikur ta dinte, Çiljetën e vuri përballë inxhinjerit dhe ky vërtet u hutua, kur pa atë vajzë aq të bukur. "Vajza, mbaroi gjimnazin, - ia prezantoi Lina. - Kemi ardhur se kemi një fjalë që i ka dalë një bursë për jashtë shtetit, për frëngjisht, në Sorbon". Edhe ajo vetë nuk e diti se nga i gjeti ato gënjeshtra, por ato bënë shumë përshtypje. "U kam thënë unë, - ndërhyri kushërira, që nga furnela, ku po bënte kafetë. - Çiljetën e kemi me aftësi të veçanta". "Ah, -ndërhyri inxhinieri,- kam një rast atëhere t'u ndihmoj. Kam një metodë shumë të mirë për mësimin e frengjishtes, mund t'ua jap. Kam edhe një fjalor". Ai foli me shumë entusiazëm dhe përsëri gratë vunë re, por Çiljeta pak më shumë, se ai ishte si i hutuar nga kjo njohje e papritur. Ai madje nuk nguroi që këtë punë ta bënte aty për aty, prandaj e ftoi Linën dhe vajzën të ngjiteshin lart dhe t'i merrnin. S'do mend që Lina pranoi menjëherë dhe u ngritën me zhurmë e shkuan lart. Në një dhomë, që ai e quante këndin e punës, ishte një bibliotekë e vjetër me dru arre dhe me shumë libra, në një kënd ishte tavolina e rëndë e punës dhe disa poltronë e kolltukë, që e hijeshonin shumë. I jati kishte qenë botues dhe i kish lënë trashëgimi shumë libra, por ai s'nguroi të tregojë se shumë libra të tjerë i kishte blerë edhe vetë, kur kishte qenë me studime në Pragë. Shtëpia e tij ishte shumë e këndshme dhe ishte aq freskët e aq e qetë, sa që Çiljeta nisi të mos druhej më. Asaj iu zgjidh gjuha, gjë që e ëma as e kishte pritur. Nisi të interesohej për disa albume me pamje nga Praga dhe për një koleksion pullash, që ishin renditur me një rregull absolut në faqet e një radhori me kapak të trashë. Ai nuk përtonte t'i tregonte gjithçka me hollësi, madje nisi të bëjë edhe humor e të qeshnin me njëri - tjetrin.

Ndenjën nënë e bijë një muaj në Tiranë. Mesa dukej, ai e kish vendosur në kokën e tij që këtë vajzë ta bënte për vete; ajo ish kaq e bukur dhe e thjeshtë, ish e çiltër dhe e urtë, pastaj e intersuar dhe e zgjuar, për të kapur shumë gjëra, pra vërtet një grua e mirë për gjithçka. Kuptohet, çdo gjë të tijën Lina ia idealizonte vajzës, e cila e pa kështu veten krejt të dorëzuar. Ia mpinë kokën darkat në restorante, mbrëmjet në shtëpinë e tij, ku ai kishte një radiogramafon dhe vinte shumë disqe me muzikë të bukur, fjalët që dëgjonin për të si njeri të zotë dhe më në fund propozimi krejt i papritur. Ai kishte vënë për këtë qëllim kushërirën e mamasë. Gjithçka ndodhi si në një ëndërr. Thanë se ishin të ftuara për darkë në Dajti dhe kushërira e mamasë nxorri nga garderobi një fustan të errët, një palë këpucë të zeza me taka të larta dhe një byzylyk me gurë të shndëritshëm, që i **rri**nte aq mirë. Vetë ato, mamaja dhe kushërira, u veshën gjithashtu me sqimë të madhe. Në Dajt, në hollin e madh, që llamburiste nga dritat, i priti ai, inxhinjeri, që kishte shkuar më parë dhe kishte porositur tavolinën. Kishte veshur një kostum të gjelbër në bojë gushrosaku, këmisha e bardhë i vetëtinte dhe dukej ashtu aq elegant sa të mbeteshin sytë. Çiljeta e ndjeu veten si të dehur midis atij luksi, pastërtie dhe gjithçkaje që ishte aty, që nga serviset dhe kamarjerët dhe deri te këndet si në gjysmë terr dhe nën gjysmë ndriçimi ngjyra- ngjyra, ku ishin tavolinat. I treguan, herë ai dhe herë kushurira e mamasë, për diplomatë të vendeve të huaja, që vinin aty, dhe, nga kjo klientelë, kuptohej se Dajti ish një hotel i rezervuar. Në një kënd, ngjitur në një podium dhe mes dritash varaku, ishte orkestra. „E famshmja orkestra e Dajtit", tha kushërira e mamasë. Afër mezit të natës, kur kishin ngrënë aq gjëra të mira dhe kishin pirë një verë të kuqe të hollë, kushërira e mamasë e tërhoqi nga vetja, u mënjanuan, që Lina dhe inxhinieri të mos i shihnin, dhe nxorri nga çanta dhe i tregoi një kuti të bukur, veshur me kadife të kuqe. Ajo e hapi kutinë dhe vezulluan përnjëherësh një unazë me gurë të kuq dhe një palë vathë të mëdhenj floriri. „Po të them e para të më trashëgohesh, - foli me një zë dramatik kushërira e mamasë. - Donim ta bënim surprizë, të ka rënë një fat i madh". Çiljetën sikur e goditi dikush në ballë dhe nisi t'i mpihej koka. „Janë nishanet e tij, edhe mamaja e ka përgatitur nishanin që do t'i japësh". Çiljeta vuri re se nuk po dëgjohej asnjë fjalë nga ana e të jëmës dhe e atij. Ata po prisnin. Kur ktheu kokën nga ata, mamaja

buzëqeshte me buzë të shtrembëruara dhe qante, kurse atij i qe harruar një nënqeshje në gjithë fytyrën dhe sikur kishte ngrirë me sytë të ngulur tek ajo. Nuk mban mend se çfarë u tha pas kësaj. Foli e ëma, foli përsëri kushërira, ai vetëm heshte, pastaj i morën dorën dhe ai i vuri unazën me gur të kuq, pastaj i lanë në dorë një kuti me unazë dhe ajo ia vuri atij në gisht. E ëma e puthi duke qarë, kushërira, si një e marrë, duartrokiti, pastaj ra orkestra, tangoja e famshme *Komparsita*, dhe ata u çuan të kërcenin. I ngritën ato të dyja: mamaja me kushërirën. Çohuni e kërceni tani, u thanë, jeni çifti më i bukur i botës.

Ndaj të gdhirë, pasi qenë kthyer nga "Dajti" dhe pasi qe shtrirë, por nuk kish mundur të mbyllë sy gjersa zbardhi, e kapi papritur një ngashërim. I kishte dalë përpara syve dhe nuk po i hiqej fytyra e Fredit. Ai e shikonte me ngulm dhe priste që ajo t'i thoshë diçka, por ajo nuk nxirrte dot asnjë fjalë nga goja. Vetëm qante.

As një fjalë, as një shenjë nga Fredi, madje as që qe bërë i gjallë, kur u bë fejesa dhe kur u bë pastaj martesa e saj. As në një rast e as në një tjetër nuk qe ndjerë. Ai sikur pat humbur përgjithmonë, sikur diku qe zhdukur. Vetëm një herë, kur Haja kishte ardhur në Tiranë (atëhere nuk kishin kaluar veçse tre-katër muaj nga martesa), i kish dhënë një copë të vogël letre, që kuptohej se ishte e Fredit. "Ah zemra! Ajo s'lënka kurrësesi të hyjë në të një i dytë. Nëse ndonjëherë gënjehemi dhe kujtojmë se kjo gjë ka qenë e mundur, hija e të parit na ravijëzohet një ditë dhe na thotë sa rëndë dhe sa tradhëtisht e kemi gënjyer veten". Kush i ka shkruar këto, e kishte pyetur Hajan dhe Haja i kish thënë se i kishte shkruar vetë. Sepse ishte shkrimi i saj, por Çiljeta e dinte se këto i gjente vetëm Fredi. Haja nuk ia tregoi të vërtetën, por kjo pak rëndësi kishte. Ajo tashmë ishte e bindur se ato fjalë vinin nga ai dhe se ato ishin plotësisht të vërteta. Një ditë i shoqi e kish pyetur: "Më dashuron?". "Po, i kish thënë ajo, të dua". S'dinte si ta shpjegonte se përse nuk kish mundur t'i thoshte "Të dashuroj". Ishin ca gjëra që nuk mund të kuptoheshin dot.

Nuk kuptoheshin ndoshta ngaqë këto vite të martesës kishin qenë për të pikërisht të tilla, që vetëm ish mësuar me të shoqin, prandaj e donte, por nuk e dashuronte. Qe mësuar pastaj edhe me një gjë të zbrazët, me një si gollë, ku jeta shket me aq rend dhe pa ndonjë kuptim. Një si brengë që ndjente e mbetur si vetëm me veten e saj dhe e mbyllur brenda një hapësire, ku asgjë nuk të bënte më përshtypje. Kurse, mbas atij çasti që kish mundur ta shohë për pak Fredin mbas aq kohësh, nuk kish më dëshirë të dilte para syve të prindëve dhe të të shoqit. Donte të rrinte vetëm dhe të mos dëgjonte më kërkënd t'i fliste. Mamaja u bë merak. I tha se përse rrinte mbyllur në dhomë dhe një ditë e tërhoqi për krahësh, që të ngrihej të shihte babanë me të shoqin, të cilët qenë ngritur shumë herët dhe po rregullonin hardhitë. Po Çiljeta s'donte kurrsesi të lëvizte nga vendi, duke i thënë se i dhimbte koka. Kishte një brengë që e përjetonte thellë tani. Nëse vendosi atëhere të martohej, a s'ishte e njerëzishme ta takonte Fredin dhe t'i thoshte atë që kish vendosur? Le të ishte sado e rëndë, duhej ta bënte këtë gjë, por, në të kundërt, i ishte fshehur. Tani s'e shmangte dot një dëshirë si në ethe: donte ta takonte. Sikur edhe për t'iu falur unjërisht për gabimin që kishte bërë, por ta takonte dhe të dëgjonte, me këtë rast, edhe një herë zërin e tij dhe të shihte edhe një herë nga afër sytë e tij. Edhe sikur ai t'i fliste vrazhd dhe ta shikonte rrept, ajo do të dinte t'ia dallonte bukurinë e zërit dhe ëmbëlsinë e syve. I çoi fjalë Hajas dhe ajo erdhi një mesdite, para se të shtronin drekën. I tha se kishte shkruar një letër për Fredin dhe duhej ta gjente dhe t'ia jepte menjëherë. "Patjetër sot", i tha.

Haja do të vinte në mbrëmje e do të thoshte se do të shkonin për ndonjë orë te rrobaqepsja e saj. Ndërsa e priste të vinte, **Çiljeta** kthehej e rikthehej te pasqyra. Flokët i rregulloi si dikur, kur ishte vajzë. I mblodhi prapa, lëshoi kaçurelet mbi ballë dhe fshiu **çdo** gjurmë tualeti. Veshi një fustan të thjeshtë, si të gjimnazisteve, dhe sandale me **çorape** të shkurtëra. Kur erdhi Haja, sapo kish rënë dielli dhe ato dolën nga porta me një frymë. Dridhej. Nuk e dinte se do të emocionohej ndonjëherë kaq shumë. Iu lut Hajas që ta afronte sa më pranë vendit dhe pastaj ta priste diku. Të rrinte vërtet te rrobaqepsia, të rrinte deri sa të shkonte ajo. Haja qe bërë më keq e heshtur. Mos vallë e dënonte për atë që po bënte? "I erdhi **çudi**, kur i dhe letrën?" e pyeti. "Pak" i tha Haja pa ndonjë ngarkesë emocionale. "Nuk i bëri përshtypje…nuk të tha ndonjë gjë kur ike?". "Më tha vetëm: bëji të fala" tha Haja.

Ndanë një sheshi të vogël, ishin ca akacje dhe nën hijet e tyre, që bëheshin më të errta nga nata, ata qenë takuar disa herë. Çiljeta u fut aty dhe ndjeu një tmerr të dyfishtë: kishte frikë se mos e njihnin, por nuk kishte edhe pikë sigurie në do të vinte ai apo jo. Ajo mezi priti që të kalonin edhe pak minuta që ora të bëhej fiks dhe, kur ora u bë fiks dhe kaluan dy-tri minuta të tjera, nuk e pati më frikën se mos e njihnin, por frikën tjetër, atë që ai mund të mos vinte. I shtrëngohej një gjë e fortë në grykë dhe s'e përballonte dot padurimin. Kaluan disa minuta të tjera dhe më në fund në shesh, pastaj duke ardhë drejt saj, u duk një djalë, nxënës i klasës së tretë të thoje. Ai erdhi dhe i zgjati një letër.

-Ma dha Fredi, - i tha.

-Po ç'të tha, ku është?!

Djali hezitoi të përgjigjej. Nuk deshi të flasë më dhe u kthye të ikte.

-Mos ik! - i tha Çiljeta dhe e kapi për supesh.

Ishte e sigurtë se Fredi ishte aty, diku rreth, ajo mund ta bënte këtë djalë të fliste. Nisën të ecin së bashku dhe ai s'kish ku e çonte tjetër. Në një kënd të oborrit të kinemasë së vjetër, ishte Fredi. Djali sikur pati frikë dhe i rrëshqiti nga dora e iku. Fredi rrinte në këmbë. Çiljeta i vajti pranë, por nuk gjente një fjalë t'i thoshte.

-Mirëmbrëma, - foli ai.

Ajo i tundi vetëm kokën.

-A nuk është e tepërt?- e pyeti ai.

-Cila?!

Pastaj shpërtheu njëherësh:

-Jo, Fredi! Asgjë s'është e tepërt. Asgjë!

S'mundi të përmbahej. I harroi të gjitha. Ngriti kokën, fshiu me nxit dy pika lotësh.

-Fred! - i tha. - Sikur ta dish sa vuaj…të më besosh, nuk të harroj dot…sikur edhe gjithë jetën, gjithë jetën.

E pat humbur. Dridhej, qante. Pastaj iu hodh befasisht dhe e puthi. Fredi u turbullua nga ajo puthje dhe nga dallga e flokëve të saj. Dikur e kapi nga supet, e vështroi nga afër, pastaj i tha:

-Domethënë ti nuk do që të heqim dorë?

Një gjë e akullt sikur ngriu gjithëçka në ajër. Dëgjohej vetëm frymarrja e tyre.

-Ti gjithmonë egoiste ke qenë, - tha Fredi. - Gur kam unë në vend të zemrës? Kujton se asgjë nuk përtëritet në shpirtin tim? Po pastaj, ç'kuptim do të kishte? E mora vesh nga letra se sa shumë të kishte marrë malli dhe sa shumë më doje. Edhe unë të jam përgjegjur. Të kam shkruar në atë letër t'i vemë pikë kësaj historie. Të mos i mundojmë më zemrat. Sepse ka një kohë të tyre kur vendosin, kohë e zemrës quhet, dhe ato kanë vendosur.

Çiljeta, përmes një kthjellimi të beftë, e kuptoi atë që shprehu ai. Pastaj tha se diku ai e kish lexuar atë që po i thoshte dhe, si e kish lexuar, e kish kopjuar dhe ia dërgonte asaj në letër me atë djalë të klasës së tretë. I shkruante për zemrën, siç kish bërë një herë, kur i shprehej për sytë. Siç kish bërë edhe shumë herë të tjera, kur i shprehej për gjithëçka, që lidhej me ta. Po, kishte qenë një kohë kur zemrat vendosin dhe ato kishin vendosur, kurse tani, vërtet, çfarë donte nga ai?

Duhej patjetër ta shkulte nga thellësitë e gjoksit një fjalë, që nuk e nxirrte dot. Çdo çast që kalonte ishte tepër i rëndë. Pra duhej patjetër ta nxirrte atë fjalë nga gryka, asgjë nuk kishte më kuptim. Dhe, si nëpër terrtit që binte në gjithë qënien e saj, mundi të thotë një "Më fal!" drithëruese. Por ai nuk e dëgjoi. Ndoshta kishte folur me vete, prandaj ndjeu nevojën ta përsërisë dhe tha me zë më të lartë:

-Më fal!

Fredi ktheu kokën dhe e pa tek po largohej mes akacieve të errta, drejt qendrës. Një dëshirë e ndrydhur me dhimbje e ftonte të rëndëte drejt saj, ta arrinte e t'i thoshte… por çfarë? Nuk mundej, nuk duhej. Rrinte në këmbë dhe kafshonte çipin e buzës. Te shtylla e elektrikut, kur ajo kaloi nëpër dritën që lëshohej në tokë, pa se si silleshin rreth saj ca petale të bardha kumbullash, që i rrëzonte era. Pastaj ajo iku matanë vorbullës së tyre, në errësirë dhe zotëroi një heshtje e thellë. Lart, në kubenë e madhe të qiellit, dridheshin yjet e ftohtë.

Si zakonisht, me ato fraza! Me ato shprehje, që se ku i gjente! Që kushedi se ku i merrte dhe ia shkruante në letrat që i dërgonte! Edhe këtë radhë po ashtu. Në një vend të dukshëm të letrës, kish shkruar me shkrim që të tërhiqte vëmendjen:

"Me zemrën nuk luhet. Ajo një herë di të këndojë dhe këtë e bën në një pranverë të dashur dhe të shtrenjtë. Kjo pranverë e zemrës është si pranvera e mimozave, që lulëzon atëhere kur malet për rreth ende s'e kanë zhveshur peliçen e bardhë të dimrit. Një pranverë, që lulëzon trimërisht në një natyrë të heshtur e të ftohtë, stolisur vetëm me një lule. Ajo na kujton pranverën e madhe, kur vërtet çelin gonxhe më të bukura, harlisen lule më erëmira, por si mimozën trimoshe s'e gjen të dytë në jetë. Ne s'e kemi ditur se ç'lule e mrekullueshme ka qenë ajo, por kur vjen dimri, kur ndjenjat flejnë në një kënd të zemrës dhe papritur zgjohen nga lulëzimi i saj i herëshëm, atëhere mallëngjehemi dhe na shpëton një psherëtimë për mimozën trimoshe, që s'e kemi dashur dikur. Kush ndjeu në zemër këtë dhëmbje, kush provoi këtë ndrydhje që bie pranvera, tha së thelli: "Duajeni mimozën, lulen e parë të pranverës suaj! Si atë nuk do të gjeni tjetër"!

Kukës,1959

RAMADAN BOZHLANI

I dashur armik Koronavirus,

Ungjize në tregun e një lagje kineze dhe u nise furishëm nëpërmjet frymëmarrjeve të njerëzve për t'i pushtuar të gjitha kontinentet e globit.

Rrugën e udhëtimit e shtrove pamëshirshëm me trupa njerëzish, duke i trandur kështu menaxhuesit e këtij planeti: njerëzit.

I përdore qeniet njerëzore sikurse përdoren veturat, trenat, anijet dhe aeroplanat për ta bërë xhiron e botës dhe në të njëjtën kohë i ngulfate pabesisht duke i kthyer në kufoma, e kështu duke shkaktuar dhimbje, pikëllim, frikë, dhe ankth tek bashkëkohësit e tyre. Siç po shihet veprove me tinëzari, pabesi dhe pashpirtësi duke na zënë në befasi!

I dashur armik, ma thuaj përse ndeze luftë kundër racës njerëzore? Urrejtja e kujt të jetësoj kundër njerëzimit? Përse ky mision makabër? Ç't'u desht dhimbja, vuajtja dhe vdekja e njerëzve?

A s'ishe i vetëdishëm se çdo betej me njerëzit pëson disfatë?

Ti po hesht, por unë do të vazhdoj të helmoj.

Në këtë kohë na bërë të dëgjojmë shumë lajme të kobshme, por, ja edhe një të tillë për ty: a je i informuar që të kemi shpallur armik të njerëzve?

E din se ç'do të thot kur damkosësh si armik i gjithë njerëzimit, sidomos në shekullin XXI?

Ja do ta them, madje me shumë kënaqësi: do të thot të fillosh t'i numërosh ditët mbi këtë tokë, sepse, ato nga çasti në çastë po t'u ngushtohen për të ngulfatur mizorisht ashtu siç dite vetëm ti të na ngulfatësh.

Ti mund ta konsiderosh s'i të duash këtë kumt, si të rremë, grotesk, tragjik apo edhe të më quajsh të çmendur. Por, kjo fare s'më bënë përshtypje, sepse, jam thellë i bindur që së shpejti do ta marrësh rrugën e hidhur, atë të zhbërjes së qenies tuaj ashtu siç ishe inekzistent. S'ke pse dyshon, ky është fati yt i pashmangshëm dhe do të ulërish deri në gërrhamat e fundit. Do të jesh jetëshkurtë, i dashur armik.

E din ti që e ke zgjuar zemërimin e mendjeve njerëzore, sidomos tek ato më me peshë siç janë shkenctarët dhe mjekët? Këto mendje punojnë ditë e natë pa pushuar deri sa ta gjejnë dermanin për të asgjasuar tërsisht dhe përjetësisht.

Këshilla ime për ty është: të heqësh dorë nga gjëma që je duke ju shkaktuar qenieve njerëzore dhe të fillosh ta qajsh fatin tënd të kobshëm.

Në kokën tënde mund të vërtitet pyetja: kush je ti që guxon t'i flasësh kështu vdekjeprurësit më të madh të kohës?

Unë me buzëqeshje po ta them, që jam një qenie letrare dhe fuqia ime aktualisht qëndëron në nxitjen e njerëzve për të mallkuar. E din ti se c'do të thot kur të mallëkohesh nga gjithë njerëzit njëzëri?

Do të thotë vdekje dramatike për ty, i dashur armik Koronavirus.

Lamtumirë, mjeshtri Gianni Belluscio!

nga Adil OLLURI

Më pikëlloj pamasë lajmi për vdekjen e albanologut, arbëreshit të ndershëm, mikut tim e të gjithë kulturës shqiptare, Gianni Belluscio. Do të më mungojë e do të na mungojë të gjithë albanologëve një njeri i drejtë, i matur e i virtytshëm, ndihmëtar i pakursyer për zhvillimin e kulturës, gjuhës dhe letërsisë shqiptare, siç ishte Gianni ynë i dashur.

Giovanni Bellusco ka lindur në fshatin arbëresh Shën Vasili (Kalabri) më 25 gusht 1961. Ka mbaruar shkollimin fillor në fshat, ndërsa liceun në Castrovillari. Është diplomuar në Universitetin e Kalabrisë, ku edhe ka doktoruar më 1993, në të cilin punonte si ligjërues i rregulltë deri në fund të jetës së tij.

Nga njohësit e fushës së linguistikës shqiptare, Gianni Belluscio është vlerësuar si një nga profesionistët dhe mjeshtrit më të mirë të fonetikës eksperimentale. Ka realizuar një varg ekspeditash në terren për t'i sprovuar edhe praktikisht rezultatet e punës së tij shkencore. Gianni Belluscio është autor i dy librave të vlershëm në fushën e tij profesionale shkencore, siç janë: "Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë, shqip, italisht, frëngjisht, anglisht" (2011, bashkëautor) dhe "The albanian language in education in Italy" (2010).

Për herë të fundit u takuam në Ostana të Italisë para dy viteve (2018), ku ai nga jugu i Italisë kishte ardhur në pjesën e saj më veriore për të ndihmuar dhe për të më përkthyer gjatë ceremonisë së dorëzimit të shpërblimit letrar "Premio Ostana Internazionale 2018". Kjo po që ishte sakrificë dhe vullnet i madh për ta ndihmuar letërsinë dhe kulturën shqiptare. Në vitin 2018 unë isha fitues i këtij shpërblimi, por aq sa i gëzohesha çmimit, aq i gëzohesha edhe shoqërimit me dy njerëz të virtytshëm, me dy arbëreshë të çmuar, Gianni Belluscio dhe Domenico Morelli. Me Giannin isha takuar shkurtazi edhe më parë në Prishtinë, por në Ostana më ra të rrija tri ditë të plota, thuajse vetëm më të dhe Mikucin (sic e quante mikun e tij, Domenico Morellin), dhe të llafoseshim për gjëra të ndryshme nga kultura e jeta shoqërore arbëreshe dhe shqitare në përgjithësi.

Kishte ardhur nga Kalabria në Ostana, rrezë Montevisios (pikë e lartë malore e Piemontit), ku buronte lumi Po, njëri nga më të rëndësishmit në Itali. U përshëndetëm ngrohtësisht me Giannin. Kjo më bëri shumë përshtypje dhe ma bëri edhe më të ngrohtë praninë time në një vend malor, si Ostana e Italisë. Derisa erdhi Gianni aty rrija thuajse vetëm, për shkak se drejtuesit e festivalit letrar e njihnin shumë pak anglishten. Ndonjë përshëndetje aty-këtu dhe kaq. E flisnin mirë italishten dhe frëngjishten, të cilat unë nuk i kuptoja. Italishten për shkak se jetonin në këtë vend, ndërsa frëngjishten për shkak se ishin komunitet i oçitanëve, që kishin lidhje të vazhdueshme dhe të afërta me Francën. Ardhja e Giannit dhe manifestimi i miqësisë dhe dashamirësisë së pakusht nga ana e tij, ma bëri më të ngrohtë Ostanën malore. Pas tij erdhën edhe miku i tij arbëresh, Domeniko Morelli, së bashku me bashkëshorten, dhe krijues e profesorë letërsie nga Torino, të cilët natyrisht se komunikonin në gjuhën angleze. Unë kisha ardhur aty një ditë më parë, ndërsa Gianni me Domenikon do të qëndronin për tri ditë më radhë në Ostana, po aq sa do të zgjaste aktiviteti letrar. Gianni dhe Domeniko gëzoheshin më shumë se unë për shpërblimin që do të më jepej, dhe kjo më bëri shumë përshtypje. Gëzoheshin që një shkrimtar nga "Arbëria matanë detit" po vlerësohej nga italianët, nga profesorët e krijuesit nga Oçitania dhe Torino. Aty për herë të parë e pash shpirtbardhësinë arbëreshe, shpirtin e madh të Giannit dhe Mikucit. Fillova t'i doja edhe më shumë arbëreshët dhe të interesohesha më shumë rreth tyre. E pyesja Giannin për çdo gjë rreth tyre. Më interesonte çdo gjë. Aty për herë të parë ia shtrova vetes pyetjen se mos këta, arbëreshët, na duan neve, vëllezërve të tyre matanë detit, më shumë se sa që i duam.

Gianni e pëlqente shumë natyrën e ashpër të Ostanës dhe dëshironte të shëtitej në çdo anë të saj për ta soditur në këmbë një mrekulli të krijuar nga Zoti, për dallim prej meje që më shumë parapëlqeja ta sodisja natyrën i ulur në terraca kafenesh, që ishin pranë drunjve të gjatë dhe pamjeve blerore. Nuk përtonte të ecte, të fliste për tema të ndryshme nga gjuha, letërsia, kultura dhe shoqëria në përgjithësi, si dhe kishte shumë dëshirë të këndonte. Dhe këndonte bukur, si një solist profesionist që e ka kaluar thuajse një jetë të tërë me këngën. Ishim të vendosur në hotelin "Rifugio Galaberna" dhe në çdo mbrëmje, pas përfundimit të aktiviteteve dhe shëtitjeve malore të Giannit, uleshim me të, zotëri Domenikon dhe bashkëshortën e tij, në terracën e këtij hoteli dhe ata këndonin me dhjetëra e dhjetëra këngë arbëreshe, që pakkush në Shqipëri e Kosovë, ndoshta edhe mund të ketë dëgjuar për to. Tash e fajësoj veten që nuk i kam regjistruar së paku disa prej tyre, ose që nuk i kam shënuar me laps tekstet e tyre. Do të ishte një pasuri e madhe. Por, gjithnjë njeriu shpreson në një rast të dytë. Ashtu edhe i kishim fjalët. Të takoheshim sërish në Prishtinë. Në mbrëmjen e tretë më lutën që ta këndoja edhe unë një këngë nga Kosova. Me sinqeritetin më të madh, ju thash se nuk dija të këndoja dhe vetëm sa do ta prishja hijeshinë e të kënduarit bukur, megjithatë për dëshirën e Giannit e këndova një këngë, por jo kosovare. E këndova këngën "Vajta kalova në gjithë Shqipërinë..." dhe atë me një vokal timin të përçudnuar dhe aspak muzikor. Përmes këngëve që i këndonin dhe përmes dëshirës që t'i rikujtonin këngë të kahershme të trevave arbëreshe, e pash që shpirti arbëresh është shpirt muzikor dhe "shpirti arbërit rron" në "këngë e ligjërime."

Ishin tri ditë të mëdha e të rëndësishme për mua, sa që më shumë më lumturuan mbrëmjet muzikore, bisedat e shumta e shëtitjet me Giannin, se sa shpërblimi që e mora në ditën e tretë të aktivitetit të përvitshëm ndërkombëtar në Ostana të Italisë. Ishin aq të shëndetshme e aq produktive ato tri ditë, sa që nuk do të mërzitsha aspak po që se do të vazhdonin këngët, bisedat e shëtitjet edhe për tridhjetë ditë të ardhshme. Tri ditë që lanë gjurmë në kujtesën time prej krijuesi letrar. Sot e pyes veten veten se si ndodh që dikush me të cilin ke pasur rast të shoqërohesh vetëm tri ditë, mund të lë gjurmë te ti më shumë se sa dikush me të cilin mund të takohesh thuajse çdo ditë. Këtë mund ta bëjë vetëm një shpirtbardhë, një njeri i dijshëm, i kulturuar e i matur, si Gianni Belluscio.

I përjetshëm qoftë kujtimi për ty, i dashuri Gianni!

NIKOLLË MEKAJSHI DHE KONTRIBUTI MADHOR I TIJ NË SHËRBIM TË KISHËS KATOLIKE SHQIPTARE

nga KUJTIM BEVAPI

Mekajshi ishte nga Mjekësi i Elbasanit, por për kontributin madhor të tij në shërbim të Kishës Katolike Shqiptare na jep të drejtën që ta radhitim atë si një nga luftëtarët e shquar në shërbim të saj.[87] Për jetën dhe veprën e tij pak është folur. Ai citohet në radhën e studiuesve shqiptarë, në studimet e tyre, kur bëhet fjalë për rolin dhe luftën e Kishës Katolike Shqiptare në shërbim të kombit kundër Perandorisë Osmane.

Të dhënat dokumentare mbi jetën e tij janë të pakta, sidomos për shkollimin dhe veprimtarinë në vitet e hershme të formimit si prelat katolik. Por gjithsesi, letërkëmbimet, pjesëmarrja dhe drejtimi i tij në kuvendet dhe tubimet kombëtare, lidhja e fortë me komunitetin dhe bashkësinë katolike, kudo që ai shkoi, e rrisin figurën e Mekajshit, duke e radhitur atë në radhën e parë të luftëtarëve katolikë në shërbim të atdheut dhe Kishës Katolike Shqiptare. Në kuvendet e organizuara u hartuan një sërë projektesh. Ato iu drejtuan sheteteve evropiane për çlirimin e të gjitha tokave shqiptare. Në promemoriet tregohej gatishmëria e shqiptarëve për luftë. U bënë përpjekje për t'i bindur qeveritë e shteteve evropiane, që të ndërmerrnin një aksion kundër Perandorisë Osmane, aksion i cili do të bashkërendohej me veprimet luftarake të kryengritësve shqiptarë dhe ballkanikë.[88] Në vija të përgjithshme, veprimtaria e tij mund të përmblidhet: rreth viteve 1585-1590 e gjejmë në qendrën peshkopale të Mamlit. Më vitin 1592 bëhet peshkop i Stefanisë apo, siç njihet nga studiuesit, Stefaniakës dhe në të gjitha dokumentet e cituara përmendet shpesh vetëm me këtë titull. Më 1595 bën përpjekje për çlirimin e Krujës dhe më 1599 shkon në Romë, si përfaqësues i Shqipërisë. Më 1601-1602 ishte ndër krerët kryesorë që përfaqësojnë Elbasanin dhe krahinat rreth tij në Kuvendin e Dukagjinit, ku bashkë me Nikollë Bardhin, peshkop i Sapës e i Zadrimës, nënshkruajnë aktet e këtij kuvendi. Qe një nga autorët e promemories, dërguar në Romë, për largimin e klerikëve sllavë nga Shqipëria.[89]

Në Kuvendin e Dukagjinit janë disa delegatë të Elbasanit, si: Ando Dorëza, ndër krerët kryesorë të Shpatit, si dhe Gjon Gindela, Marin Mashi, Dhimitër Protonotari, po të Shpatit. Ndërsa Leva (Leka) Dukagjini, Petër Skura, Petër Simili (Shmili), përfaqësonin Elbasanin.[90] Kuvendi në Dukagjin u mbajt pranë kishës së Shën Lleshit (Aleksandrit). Morën pjesë rreth 2656 delegatë laikë e fetarë, të ardhur nga 14 krahina të Shqipërisë: Malësia e Shkodrës, Zadrima, Dukagjini, Kosova, Lezha, Kurbini, Mati, Dibra, Petrela, Durrësi, Elbasani, Shpati, Myzeqeja. Kuvendi u drejtua nga Nikollë Mekajshi, Nikollë Bardhi, Gjin Gjergji. Ai mori vendimin që të fillonte luftën për çlirimin e vendit, të cilin e nënshkruan 52 krerë kryesorë, 4 nga çdo krahinë. Ata iu drejtuan Papës së Romës dhe Venedikut për të siguruar aleatë dhe ndihma me armë, por si Papati, ashtu edhe Republika e Shën Markut, i "këshilluan" shqiptarët se ende "nuk kishte ardhur koha për luftë kundër turqve".

Përpjekjet e tyre për të siguruar një aleat të jashtëm dhe armë zjarri, nuk dhanë rezultat. Të nisur nga interesat vetjake, për të ruajtur paqën me Perandorinë Osmane, shtetet kryesore katolike nuk u dhanë shqiptarëve ndihmën e kërkuar.[91]

Nikollë Mekajshi ishte nga ata prelatë "rebelë", i cili me guxim u vu në ballë të kryengritjeve antiosmane, në vitet 1592-1615 dhe punoi pa u lodhur pr organizimin e kryengritjeve apo lëvizjeve antiturke në Shqipërinë e Mesme dhe në atë Veriore. Në letrën që Mekajshi i dërgon Kardinalit Jul Aldobrandini, më 29 korrik 1603, i parashtron gjendjen e vështirë të klerit në Shqipëri dhe e informon për kryengritjen në Dukagjin. Sipas tij, në Shqipëri nuk duhej të kishte më shumë se 130 priftërinj katolikë, kur numri i të krishterëve katolikë shkon në 150 mijë. Krahina, si: Bërzeshta, Polisi dhe Çermenika, me rreth 4000 katolikë kanë vetëm një prift keqbërës, që jep shembull të keq.[92]

Një pjesë e mirë e letërkëmbimit të tij i kushtohet organizimit të një kryengritjeje të fuqishme kundër osmanëve. Duket që Mekajshi me shokë të tjerë punonin seriozisht mbi këtë kryengritje, duke llogaritur e planifikuar forcat e jashtme dhe të brendshme, të udhëhequra nga fuqitë katolike. Në këtë kontekst ai i dërgon Papa Klementit VIII një projektrelacion më 1603 dhe jep një përshkrim të limaneve të Shqipërisë, tregon forcën dhe gjendjen e kryengritësve. Duhet përmendur fakti që raportet e tij me Venedikun qenë prishur, duke shkuar deri aty, sa venedikasit i shkruajnë sulltanit: "Ruajuni nga Peshkopi i Stefanisë, sepse ai do t'ia lëshojë Shqipërinë Papës dhe spanjollëve".[93] Mekajshi dhe shokët e tij survejoheshin nga Venediku.

Autori i projektrelacionit e njeh mirë vendin dhe bën një përshkrim topografik të saktë, duke folur për Veriun, Pjesën Qëndrore dhe atë Jugore. Interesant është fakti që Mekajshi e konsideron Shqipërinë mbretëri, me një qendër metropoli dhe këtë e bën me një qëllim të caktuar, siç do të vërejmë më poshtë. Kjo mbretëri ndahet në katër provinca të populluara, ku ka fshatra, qytete, kështjella dhe në secilën krahinë ka selinë sanxhakbeu turk. Provinca e parë është vendosur në një vend detar në vijën bregdetare të Shqipërisë me Durrësin, Vlorën, Shëngjinin, Ulqinin etj, ndërsa në provincën e dytë, në brendësi të vendit, vendos Elbasanin (Albasanin), rreth 40 milje larg detit, por si qytet me seli të sanxhakbeut, rrethohet nga një mur me rreth një milje, pjesërisht të rrënuar nga tërmeti.

Ka një varosh me 700 shtëpi dhe rreth e rrotull ka shumë fshatra. Në këtë krahinë ka shumë qyteza, qytete e kështjella dhe është provinca më e fortë që gjendet në Shqipëri, sepse mund të armatosë në një kohë të shpejtë, deri në 20.000 luftëtarë myslimanë dhe ortodoksë.

Ndërkohë survejimi i Venedikut ndaj Mekajshit, takimeve të tij me miq e figura të njohura vazhdojnë. Rektori proveditor i Kotorrit lajmëron Senatin e Venedikut për informacionet që ka mbledhur nga persona të veçantë, mbi veprimet e peshkopit të Stefanisë për të shtruar bisedime për marrëvshje me spanjollët. Letra mban datën 9 mars 1607.

Kryengritja e projektuar nga Mekajshi dhe katolikë të tjerë të besuar të tij, kish filluar të konturohej dhe se përmasat e saj duket se i kalonin kufijtë e Shqipërisë. Ajo do të rrokte trevat e Ballkanit dhe shkonte deri në qendër të Perandorisë. Mekajshi shpresonte shumë te fuqia katolike e disa vendeve të Perëndimit, në mënyrë të veçantë të Spanjës, për t'i dhënë fund sundimit osman. Në këtë kontekst ai dërgon në Napoli dy besnikë të tij për bisedime lidhur me kryengritjen. Këtë informacion e përcjell përfaqësuesi i Venedikut në Napoli, duke njoftuar sinjorinë se këtë dërgatë e ka nisur për bisedime peshkopi i Stefanisë. Letra është e datës 9 qershor 1608. Madje njëri prej tyre ka ardhur enkas nga Kastelnovosti (Elbasani) i Shqipërisë. Me të dërguarin e Napolit Nikollë Mekajshi është takuar dhe në Kep të Rodonit larg "syve kureshtarë", duke u cilësuar si një takim me peshkopin e Rodonit, ndonëse një peshkop të Rodonit nuk ka patur në këtë periudhë.

Por një kryengritje me përmasa

të tilla, një survejim i Venedikut dhe një përndjekje e hafijeve turke ndaj peshkopit të Stefanisë, sado e fshehtë që të ishte, nuk mund të futej në një grykë thesi e të mos merrej vesh. Mekajshi kish marrë arratinë në malet e Dukagjinit. Françesk

Skoroveu, abati nga Budva, e informon sinjorinë e Venedikut për veprimtarinë e peshkopit të Stefanisë për çështjen e kryengritjes shqiptare dhe flet mbi gjendjen në Kelmend e Dukagjin, ku, siç thuhet, prodhohen barut e arkibugja.[94] Gjithashtu letërshkruesi informon, për aq sa ka marrë vesh, lidhur me përgatitjen dhe ujdisjen e spanjollëve për të pushtuar Kotorrin, Kastelnovon (Elbasanin).

Por vlerësimin më të madh Mekajshit ia bëjnë krerët katolikë shqiptarë në një letër dërguar mbretit Filip të Spanjës, duke e zgjedhur atë përfaqësues të tyre, "...të përndriturin imzot Nikollë Mekajshin, peshkop të Stefanisë, si ambasadorin tonë të vërtetë e të saktë"[95], shkruar për udhër të mbretërisë nga sekretari Dom Pjetri I Zi, abat i Shën Palit, 26 mars 1609.

Ndërkohë, mbas një pauze tremujore, Mekajshi i drejton një letër mbretit të Spanjës, Filipi III, më të cilën i parashtron kushtet e favorshme, që tanimë ishin pjekur për luftën e përgjithshme, duke i paraqitur atij një plan konkret veprimi.[96] Ai sugjeron që me hapin e parë të merrët Albasani,



Vula Peshkopale e Nikollë Mekajshit, e ruajtur në koleksionin e Shtjefën Gjeçov Kryeziut

metropol i asaj mbretërie. Elbasani, si seli kryesore e mbretërisë, qe zgjedhja e gjetur nga autori, mbasi nuk mund të mendohej mbretëria pa patur një qendër kryesore. Në planin e tij jepen me shifra konkrete dhe radhë veprimi për ndërhyrje që qytetet kryesore e më pas ndërhyrjet e Spanjës në vende, si: Serbia, Greqia, Bullgaria, Traka e, më në fund, Kostandinopoja.

Pa u vonuar, më 29 gusht 1609 mbreti Filip III i Spanjës i kthen përgjigje Mekajshit dhe e këshillon të mos shkojë pranë tij në Spanjë, siç kishte propozuar vetë peshkopi, por të mbajë korrespondencë me ambasadorin e tij në Romë, kontin De Kastro.[97] Por "rebeli" shqiptar kërkon ta çojë deri në fund inkursionin në të mirë të popullit të tij dhe për të fituar siguri, me këmbëngulje i dërgon një tjetër letër nga Roma, mbas 29 gushtit 1609, mbretit të Spanjës, duke e siguruar se populli shqiptar qëndron në pritje, pa ndërmarrë asnjë veprim, sipas porosisë së tij, derisa çdo gjë të jetë organizuar mirë. Për sa u takon lëvizjeve me armë, malësorët i mbajnë gjithë kohën, pa ngjallur asnjë dyshim tek turqit.[98] Mekajshi është gati të derdhë dhe gjakun e tij, nëse është e nevojshme, për zellin ndaj Zotit dhe dashurinë që ushqen për Madhërinë e Shenjtë të Mbretërisë Katolike.

Si një fuqi e konsiderueshme katolike, Spanja dhe mbreti i saj, Filipi III, e kishte ngritur flamurin në pushtimet e vendeve të ndryshme të botës. Në emër të katolicizmit përpiqej të zëvendësonte pushtimin osman me pushtimin spanjoll edhe në vendet e Ballkanit.

Mekajshi besonte dhe shpresonte deri në fund se Mbretëria e Spanjës apo aleanca politiko-fetare ndërmjet Papatit, Mbretërisë së Napolit apo të Spanjës do të realizonte luftën çlirimtare kundër Perandorisë Osmane. Në pritje të sinjalit të fillimit të luftës çlirimtare kundër turqve, Peshkopi i Stefanisë ndien keqardhje apo zhgënjim nga kjo pritje e gjatë dhe më 15 korrik 1610, afërsisht një vit mbas letrës së Mbretit të Spanjës, Filipi III, Mekajshi i prashtron Papës një relacion lidhur me problemet e realizuara, gabimet e bëra deri tani prej princërve të ndryshëm dhe ç'mbetet për t'u bërë për luftën çlirimtare. Me një letër të shkurtër përcjellëse, drejtuar Kardinalit Borgeze, në datën 15 korrik 1610, peshkopi shoqëron parashtresën apo relacionin caktuar për Papën, duke thënë: "Unë do të qëndroj duke pritur prej Shenjtërisë së Tij (Papës) përgjigjen". [99]

Relacioni fillon me fjalët: "Atë i lumtur! Gabimet kryesore të princave të sotëm janë: guxim i paktë nga frika e madhe, që të vihen të bëjnë punë të denja për ta. Prandaj ndodh që një lumturi e madhe, të cilën mund ta gëzonin, atyre nuk u vlen, sikundër një krevat ari, që nuk do t'i vlente një të sëmuri...".[100] I pezmatuar dhe me pak shpresë, ai edhe një herë parashtron argumentet e tij, duke e parë Papën si shpresën dhe shpëtimtarin e vetëm, duke i kujtuar se tek Ai (Papa) e dërgoi populli, dëshira për t'u çliruar, për t'u dhënë atyre ndihmë, që të çlirohen njëherë e mirë nga ajo zgjedhë mizore.

Nuk e dimë se ç'përgjigjje i ktheu Papa peshkopit, por Mekajshi nuk mund të depërtonte në konjukturat politike të luftës që zhvillohej ndërmjet Perandorisë Osmane dhe vendeve katolike.

Vdiq në mërgim më 1615.

---

85) Z. Shkodra: Islami dhe institucioni esnafor në Shqipërinë etnike. Në: Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët. (Simpozium Ndërkombëtar, Prishtinë, 15-17 tetor 1992), Prishtinë, 1995, f. 138
86) K. Halimi: Dervishët dhe tempujt e tyre në përgjithësi dhe në Kosovë. Në: "Trajtime dhe studime etnologjike". Prishtinë, "Instituti Albanologjik", 2000, f. 72
87) :Fjalori enciklopedik shqiptar, Tiranë, "Akademia e Shkencave e RPSSH, f.688. Zëri hartuar nga I. Zamputi.
88) Historia e popullit shqiptar, vël. 1, Tiranë, "Toena", 2002, f. 566
89) I Zamputi: Dokumente të shek. XVI-XVII për historinë e Shqipërisë, vol. 2. (1593-1602), Tiranë, 1990. Dok. 34, 160, 194
90) I. Zamputi: Dokumente...., Dok. 183
91) Historia e popullit shqiptar, vol. 1, Tiranë, "Toena", 2002, f. 568
92) Dokumente të shek. XVI-XVII për Historinë e Shqipërisë, vol. 3 (1603-1621), Tiranë. Dok. 5, f.35
93) I. Zamputi: Dokumente.... vol. 3, dok. 9, f. 44
94) I. Zamputi: Dokumente...., vol. 3, Dok. 150, f. 221
95) I. Zamputi: Dokumente...., vol. 3. Dok. 157, f. 231
96) I. Zamputi: Dokumente...., vol. 3. Dok. 158, f. 232.
97) I. Zamputi: Dokumente...., vol. 3. Dok. 160, f. 241-242
98) I. Zamputi: Dokumente.... .vol. 3. Dok. 161, f. 242-243
99) I. Zamputi: Dokumente.... .vol. 3. Dok. 165, f.247
100) I. Zamputi: Dokumente... ..vol. 3. dok. 165., f. 248

VDES NGA KORONAVIRUSI SHKRIMTARI I SHQUAR KILIAN LUIS SEPULVEDA

Ai ishte shtruar në një spital në Oviedo që nga fundi i muajit shkurt sepse ishte infektuar gjatë një festival letrar në Portugali.

Carmen Yanez, bashkëshortja e shkrimtarit, gjithashtu e infektuar, megjithëse në një formë më të butë, kishte treguar medias se kushtet shëndetësore të Sepulveda ishin përkeqësuar tepër.

Autori bestseller Luis Sepulveda, i lindur me 4 tetor të vitit 1949 në Kili, e kaloi pjesën më të madhe të jetës në Spanjë. Tetorin e kaluar Sepulveda e festoi 70 vjetorin e lindjes në Milano.

Disa nga veprat e Sepulvedas: 'Plaku që lexoi romane dashurie', romani i tij debutues.

'Bota në fund të botës', romani i tij i dytë, ku përshkroi jetën e gjuetarëve të balenave .

Sepulveda u bë shumë i njohur kudo në botë me romanet "Ditari i një vrasësi sentimental", "Trëndafilat e Atacama" dhe "Historia e një pulëbardhe dhe një mace që i mësoi asaj të fluturonte". Libri i fundit është realizuar edhe si film i animuar.

SHPALLEN FINALISTET PËR ÇMIMIN LETRAR TË BASHKIMIT EUROPIAN

Tre finalistët nga Kosova:

- Azem Deliu, *Shënimet e krimbit Smolinski* (*Notes of the Worm Smolinsky*), publisher: Onufri
- Majlinda Bregasi, *Gërsheti i prerë* (*The Cut Braid*), publisher: Koha
- Shpëtim Selmani, *Libërthi i dashurisë* (*The Booklet of Love*), publisher: Armagedoni

ETYDE DHE VIZATIME PSIKOLOGJIKE

PANDI RAIDHI, IKONAT DHE SHTOJZOVALLET

nga Xhevair Lleshi

Pandi Raidhi s'ishte plak, burrë pesëdhjetepesëvjeçar qe, por pas rolit dukej papritur i rrënuar dhe si i sëmurë, fytyrën (duke larguar grimin) ia brazdonin rrudha të panumërta, kurse mjekra farefare e shkurtër saqë s'mund të quhej mjekër, disi e dendur, vende-vende me thinja të bashkuara (shih rrushi rrushin piqu...), e tregonte edhe më të lodhur. Ku humbi ai zëri i tij që dilte si i shuar, fjalët që i zvargte (mos ndoshta e bënte qëllimisht?) si me përtim, pastaj i shpifej një kollë e re, e papritur, që ia shtrëngonte gjoksin ku vinte pa dashje pëllëmbët dhe kërrusej tërë shqetësim, dhe donte s'donte shihte me një lloj alarmi të frikësuar, siç shohin ata të roleve të tij kur i përndiqte mendimi i keq për veten apo për partnerin në lojë. Kurrë s'e kishin dëgjuar të thoshte me siguri ç'i dhembte, por shì atëherë niste një rrëfim ndryshe, siç e kishte zakon ta tirrte dhe ta bënte tërkuzë, paksa ngjirur dhe i pëlqente ta thoshte *ala fshatarçe,* tregonte se atje në uzinën e precizonit të lartë kishte ngritur një herë një arkë të rëndë dhe i dukej se qe rënduar atje ku s'tregohet, dhe prej saj i erdhën ditë pas dite disa të këqija, të cilave, një nga një hapu derën pastaj, u detyrua të kridhej thellë e më thellë brenda vetes, të sundonte mendimin e tij. Në një çast të tillë meditimi e gjeta në turizmin e Beratit, ku ishte ulur me Aleko Prodanin dhe me Sheri Mitën. Të dëgjoje një moment dialogun e tyre duhet të ishe syçelët se mos përfshiheshe padashur, ndryshe duhej të largoheshe, ta braktisje tavolinën, se do të ktheheshe në një viktimë. Pranova këtë të fundit dhe më shpëtoi fakti që ata i bluante vetvetja dhe marrëdhënia treshe.

- Të drejtën, s'më puqen pipat me ty Sherì, - vijoi duke gjerbur kafenë që aty veçanërisht bëhej fantastike. - E di, të kam në këmbë të vëllait të vogël, por mos harro se i madhi s'përflitet! Po ç'flas! Se mos e njihni ju frikën nga Zoti!

Të katër me siguri menduam (ose të paktën mendova unë dhe nga sytë e tyre e kuptova se edhe ata mendonin po ashtu...) se edhe ai s'e njihte atë frikë, por e ndryshova mendimin kur u ngjitëm në muzeun *Onufri* ku ai iu qep ikonave për një kohë të gjatë dhe se ç'fliste si me vete ende nuk arrita ta kuptoja, se lëshonte një zë paksa të zvargur e të ëmbël. Atë lloj pëshpërime s'e kam vënë re askund tjetër. Ishin fjalë që thuheshin me shumë shpirt, të njohura dhe që ndoshta i përkisnin vetëm atij.

«Falna, o Zot!...»

«Turp nga perëndia! S'ka ditë që mos i them vetes e t'i thërras mendjes, të ndihem i penduar për mëkatet, po pse dëgjon kjo kokë...?!»

Erdhën katër gota uiski. Sheri ua vizatoi menjëherë portretet në ajër dhe ato ngrinë pikërisht aty. Do të rrinim gjatë të ngrira? Veç t'ia shihje sytë Pandi Raidhit. Të prekte menjëherë. Ca sy si ata me aq dritë dhe lëvizje plot kuptim nuk kam parë. Të ngulej mu në bebëz dhe nuk i dridhej qerpiku. Nuk prapulste sytë Pandi. Aty ishte një det i tërë mendimesh. Aty po ta ndieje veten të zotin mund të gjeje thënie e kundërthënie, pyetje të panumërta, përgjigje të krisura, ndjekje gjatë një lëvizjeje të papritur, ngasje që shprehte ndjenjë dhe asnjë emocion, sado i fortë, nuk e tërhiqte në vëmendjen e përqendruar. «Do të vish?» - e pyeti Sheri. «Jo!» - më tepër ia bëri me sy Pandi. Ai po mundohej të dinte mendimin e tij nëse e pranonte apo jo rolin. Pastaj e ktheu njëherësh gotën me uiski. «Ka burra këtu!» - tha. Ndërkohë u dëgjua një britmë e zemëruar. Të gjithë kthyem kokën nga dera hyrëse.

Xhemil Hoxha, biciklisti i njohur dhe *babashehu*, që përgatitej të hipte në fron, kishte hapur trastën magjike dhe dy-tre gjarpërinj i lëshoi në sallën e madhe. S'mbeti njeri brenda. Na mbeti edhe uiski pa pirë. Vetëm një njeri qeshte: Pandi Raidhi. Më vonë do të merrnim vesh se e gjitha ishte një lojë, sirrë e Xhemilit. E për të mos e lënë në baltë kolegun (edhe Pandi të magjepste jo vetëm me rolin!) qeshte me të madhe derisa gjarpërinjtë erdhën dhe u futën vetë në trastën prej leshi të *shehut*. Ka qenë gjithnjë *me ato* thoshin për Pandin. Pas asaj që ndodhi në turizëm, gjithnjë me mishin kokërr, u ngjitëm në Kala, për muzeun e ikonave. Ishte kohë e bukur. Dhe mbi të gjitha të mrekullonte Tomori përballë Kalasë me një madhështi epike. Sa orë ndenjëm aty? As mua s'më vjen ndërmend, por teksa po zbrisnim në grup, ndërsa Sheri dhe Aleko nuk mbaronin hidhje-pritjet, ai nuk dilte dot nga ekstaza shpirtërore me ikonat. «Të madhërishme!» - thoshte si me vete. Duheshin veshë të mprehtë. «Sikur të rrinim më gjatë aty... Po më duket se u mërzit ajo zonjusha, bukuroshja e muzeut. Apo s'të merrte më qafë! Ç'sy! Se, syri syrin e ndjek! Qafirët!» I ndërhyra me takt për ikonat. «Hm. Nuk di ndonjë të veçantë për të tjerët, por unë komunikoj me to. Nuk shtoj asgjë tjetër por unë flas me ato. Pa zë. Domethënë mendoj. Edhe mendimi i tyre më vjen. Të ka rastisur? Vërtet? Qenke i madh mo! S'të kam njohur dhe kam frikë se do të harroj, por do t'i them Sherit t'ma kujtoj. Se me të takohem më dendur... Si? Berati ta jep këtë. Ja, e ndien energjinë që të jep krejt papritur Tomori? Tomori e mban gjallë këtë Kala, ta dish. Nuk janë broçkulla këto... Cili mund të ishte një komunikim i çuditshëm me ikonën? Një i krishterë e mban ikonën ku të jetë. Dhe i flet asaj po edhe merr përgjigje prej saj. Fjalët e përditshme themi. Ato të jetës. Dhe fusin hallin brenda tyre. Ikona na kupton dhe na përgjigjet me fjalët e Zotit, të Biblës...»

«Dëgjomë mua ti, a e sheh në sy ikonën? Po. Edhe ajo të sheh, se ti e kërkon apo jo? Ja, siç na qëlloi neve sot në Katedrale. Sytë e ikonave nuk të gënjejnë kurrë. Edhe kur luaj në skenë unë me to llafos. Ato më mbajnë gjallë. Më japin një bukuri të madhe në shpirt. E kam nga mëma gjithë këtë fat për fjalën dhe zërin që *di ta fsheh*. Se, ta dish, këtu është sekreti, *ta fshehësh zërin*, se për ta nxjerrë e nxjerrin të tërë... Po pastaj, ku ta fusësh, hë?! Ikonat sikur kanë dalë nga *shtojzovallet* duke u krehur me to. Mos më thuaj se nuk e ke vënë re. Kur bisedon me to ndihesh sikur të çelet botë tjetër. Është *orgazmë*. Sa herë del në oborr, a nuk i ke vënë re? Ato të rrethojnë, *shtojzovallet*. Të fanepset bukuria e tyre, të ndjellin vetë ato... Shtojzovallet kanë bërë kërdinë në Berat! Ato i kanë rrëmbyer djem e vajza dhe i kthyen në ikona... ja këto kam llafosur sot. Më thanë edhe emrat, edhe farën që mbanin në dorë, edhe sytë e lënduar që rrjedhin lot të padukshëm, edhe buzët plot afsh që vetëm puthin. Për herë të parë ikonat më kanë thënë të dua. Kjo ndodhi në një muzg vjeshte kur dielli sapo lindi dhe shkrepi syrin magjik mu në lule të ballit tim... Se di edhe të luajë ikona me ty, me mua. Kurse Alekon e llallis... Them *Alekos* se atë e kam mikun më të mirë...» Dhe qeshi. Qeshi me gurgullimë. Dhe unë për herë të parë e pashë me kapele strehëgjerë që natyrisht i shkonte. E përfytyrova me mjekër të zezë dhe sy të mëdhenj plot gjallëri...

«Të thashë se në skenë më ndihmojnë ikonat dhe shtojzovallet. Ato, ato ma mësuan magjinë. Ç'magjizeza them. Sirrën, po. Më pëlqen të krijoj pak ujë para teje. Dhe po të ishe shtojzovalle do të detyroja të ngrije paksa mbi gju fustanin, ta dish...»

Ai zbriti nëpër kalldrëm duke u mbajtur gjoja te krahu im dhe për të mos e parë sesi mbeti gojëhapur nga çdo sy i Mangalemit dhe nga rruga që bënim, pa ditur ku t'i mbanim më parë, për një çast mbeti ligsht, i trazuar. Zë si i tiji atë çast s'kisha dëgjuar. Thirri fort, në mes të njerëzve: «O Krisht, o Shën Mëri!» Dhe shtangëm. Ai nuk dinte ku ta shpinte veten. Ndenjëm dhe e pamë fort njëri-tjetrin të befasuar, sikur e kishin humbur një çast dhe tani po e gjenim sërish. Dhe mbetëm ashtu për gjithmonë...

Tiranë, më 12 prill 2020

Dy sy si dy botë

-në përkujtim të letrarit Përtef Kruja-

nga Alban Gjata

Është e diel, diku nga viti 77. Jam 7 vjec. Gjendem në oborrin e shtëpisë. Sefer Efendiu është emri i lagjes në kodrën e Durrësit. Lidhet me pjesen tjetër të qytetit nga një rrugë dytësore, që përshkon Durrësin përsëgjati, rrëzë kodrave. Vetëm 100 metra nga fillimi i degës kryesore të Seferit, shfaqet Furra e Ibishit. Një potpuri aromash shpërndahet nga hyrja e saj. Eshtë furra ku e gjithë lagjia pjekë tavat me byrekë e speca të mbushur. Furra e Ibishit është i vetmi istitucion social i lagjes.

Arrij në rrugicën time, shtyj derën e drunjtë të oborrit. Dera lëkund këmbanen e varur lart dhe kjo lajmëron ardhjen time. Eshtë e njëjta këmbanë që ka lajmëruar me qindra herë gjyshin për kthimin e fëmijëve kur ai kishte humbur shikimin.

Sot është e dielë. Unë sot kam detyrë të coj hashuren tek halla Shpresa. 5 porcione; një për hallën, tre për vajzat dhe një për të atin e tyre, Pertefin.

Shtëpia ndodhet nga ana tjetër e kodrës së Durrësit. Aty ku fillojnë disa shkallë guri dhe gjendem perpara hyrjes së një pallati tre katesh me fasade ovale me tulla, ndërtim italian. Salloni i hyrjes të percjellë në një shkallë skenografike

që të con në katin e sipërm. Dhe ja ku jam në shtëpinë e Pertef Krujës. Një shtëpi plot dritë. Disa akuarele dhe libra, kudo libra. Me afrohet paqsor nje burrë reth te 60ave. Ne veshjen e tij klasike mbizoteron e bardha e këmishës. Sytë e lengshem e melankonikë jane si dy botë. E ndjej veten të vlerësuar si një mbret. Vetëm 7 vjec dhe mbret!

Ky njeri, personifikim i përultësisë e mirësisë, është mesuesi letersisë i shumë brezave në Durres. Njohës shumë i mirë i disa gjuhëve dhe perthyes i Gëtes; autor i studimeve e shkrimeve të shumta dhe për 17 vjet drejtor i Bibliotekës së Durrësit.

Këtu njohja direkte me të ndërpritet dhe ky "flashback" është vetëm një shkas për të falenderuar ekzistencën e profesor Pertef Krujës.

Por kush eshte Pertef Kruja? Ai lindi më 1921 në qytetin e Shkodrës në një familje të nderuar intelektualesh. Në Shkodër ndjek filloren dhe më pas gjimnazin e qytetit.

Më 1940 regjistrohet në Fakultetin e Shkencave Politike ne Universitetin e Romës. Ndërsa më 1943, gjatë pushimeve verore kthehet në atdhe pranë familjes dhe nuk arrin të kthehet më në bankat universitare, për shkak të kapitullimit të Italisë dhe gjendjes kaotike. Që aso kohe emri i tij shfaqet në shtypin më serioz të kohës. Ai bëhet një nga korrespodentet e rregullt të revistave e gazetave, si " Drita" e "Tomorri" me anë të poezive, përkthimeve dhe tregimeve origjinale.

Ne verën e vitit 1945 emërohet në seksionin e kultures se qytetit te Shkodres. Një vit më pas atë e caktojnë mësues në Kavajë. Dhe dy vite më vonë për nevoja immediate të arsimit të mesëm e emërojnë professor letërsie në gjimnazin "16 Shtatori" të Durrësit.

Ish nxënësit e tij e kujtojnë si figurën më të dashur të viteve të gjimnazit. Shpjegimet e tij të rrisnin etjen për liri dhe arrati mendore. E megjithëatë në vitin 1961, me kerkesen e tij, largohet nga arsimi dhe i besohet drejtimi i një prej institucioneve më të rëndësishme kulturore të asaj kohe, biblioteka e qytetit.

Në vitin 1966 perfundon në Tiranë Fakultetin Filologjik në degën e Gjuhës dhe letersisë. Afërmendsh që ai shkëlqen si student duke dëshmuar gjithë atë bagazh dijesh e kulture. Me sa duket kjo diferencë e theksuar me të tjerët e brezit të vet ndikon që të emërohet më pas pedagog në Filialin e Universitetit, në Durrës.

Del në pension më 1981, pas shumë vitesh pune e krijimtarie dhe rimerret menjëherë me pasionet e tij vitale, përkthimet dhe krijimtarinë letrare. Ai dëshmon se posedon një listë të ngjeshur titujsh poezie, proze, romanesh si dhe natyrisht perkthimesh.

Nga puna si përkthyes mbetet që në krye të herës libri me balada të Gëtes. Ndërkaq ai spikat edhe si perkthyes i një serë romanesh te njohura dhe novela te asaj kohe. "Kryqi i shtatë", "Suedezi i llotarise", "Ditari i Ana Frankut", "Nata e gjatë" etj.

Pertef Kruja është gjithashtu edhe studiues i letërsisë me punimet mbi: romantizmin dhe realizmin e Balzakut, Pashko Vasen, etj.

Por një i panjohur i madh Pertef Kruja vazhdon të mbetet përtej botimit të romaneve të veta "Endërra e Pjeter Hilës" (1997) dhe "Brezi Krahëthyer" (2000).

Pertef Kruja ndërron jetë në qetësi e paqe në qytetin e vet të tretë e të fundit, në Tiranë, më 2004.

Alban Gjata
Milano, Prill 2020

Johann Wolfgang von Goethe

MBRETI I XHINDVE

Natën, për erë, kush kalin nget?
Baba vrapon me fmin' e vet
E strukë pranë vehtes djalin ndër krahë
E shtërngon, ngrohet dhe kalin grahë.

0 bir, pse ftyren me frikën mbulon?
Mbretin e xhindve, babë, s'po e shikon,
Kaftanin t'gjatë, kunorën n'krye?
0 bir, prej mjeglles t'duket kshtu ty.

Voglush i dashun hajde me mue,
Me lojna t'bukra kemi me u gzue,
Lule gjith ngjyra n'brigje kanë çelë,
Dhe petka t'arta im'amë na sjellë.

O babë, o babë, s'ndigjon ti vetë
Ka mbreti i xhindve po m'premton lehtë?
Pusho, qetsohu, o biri im:
Nga gjethe t'thata vjen kjo zhabllimë.

Djalosh i ambël, me mue s'po vjen?
Vajzat e mija t'presin me shend;
Vajzat e mija ndër valle prijnë,
Me kangë e valle gjumin ta bijnë.

Përkthyer nga Petref Kruja

ANDRRA ASHT JETA...

Një sprovë mbi poezinë e Ledia Dushit

nga Fatmir Alimani

Vijon nga numri i kaluar

9. Krimi është ende mes nesh

A e dini ju, që në kohët e vjetra, dashuria, quhej krim?

William Blake e dinte.

Por, a e dinë, këtë tmerr, njerëzit e sotëm?

Nuk e dinë, por bëjnë sikur e dinë. Njerëzit harrojnë shpejt edhe emrat e tyre. Ky është një krim, gjithashtu. Por Ledia nuk di të harrojë. Mbi poezinë, ajo nuk vë asgjë tjetër. Në këtë situatë, edhe mungesa e fantazisë, do të ishte një krim. Edhe monotonia, edhe kitsch-i, edhe çfarë akoma?

Në poezinë e Ledia Dushit, një gjest ose një fjalë, mund të provokojë një dramë të plotë. Nuk është fjala thjesht që ta kuptosh botën, vetëm si një dramë, por që të njohësh disa gjëra themelore, që i përkasin një jete normale njerëzore. Është fjala për ta dashur botën më shumë se vetveten.

Krimi tashmë ka bërë mjaft hapa më tej. Dashuria na u bë veçse seks dhe asgjë tjetër. Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë, që nuk ka më dashuri, por seks dhe vetëm seks. Kësisoj, dashuria na u bë një karikaturë. E, një karikaturë e tillë, është më e ligë se një krim dhe më e llahtarshme se një dramë. Kjo është vënë re, që në shekullin e nëntëmbëdhjetë.

Lirika dramatike origjinale, metafora e kudogjendshme dhe befasuese, fantazia sfiduese dhe e pashtershme, si dhe abstraksioni i saj i jashtëzakonshëm, e bëjnë Ledia Dushin, një poeteshë, e cila mund të befasojë fare mirë edhe në rangun evropian apo më gjërë, pa asnjë dyshim apo ngurrim. Në mendimin e saj individual e universal dhe në shpërthimin e ndjenjave dramatike, ajo e flijon vetveten, sa herë që është e nevojshme. Abstragimi që ajo ndërmerr, ka përmasa të pazakonta dhe arrin të zbulojë edhe gjërat më të skajshme dhe më të sofistifikuara. Ajo lëviz nga toka në qiell, krejt lehtësisht.

Përqëndrimi absolut estetik, arrihet vetëm nëpërmjet një abstragimi mjaft të guximshëm dhe mjaft racional.

Pyetjet janë të domosdoshme.

Përse nuk skuqen njerëzit për krimet e tyre? Në këtë rast, liria jonë e aqshumëndërruar, ka humbur thelbin e vet, duke u bërë një zhgënjim i madh dhe një parodi tronditëse. Është krejt e qartë përse në këtë rast përdoret shumësi.

Jemi të shfrenuem

Shpirt...

Ahma!

S'jemi t'lirë.

A nuk është një krim i madh, që në liri, të mos jemi të lirë, por thjesht "të shfrenuem". S'jemi në parajsë. S'jemi në ferr. Ku? Ku jemi, atëherë? Ndoshta, në Askund?

Por zhgënjimi apo krimi shkon më tej, duke marrë përmasa apokaliptike. Tashmë "thonë se asht verë", por në të vërtetë, "t'gjithë jemi tue vdekë", dhe madje, "njerëzit s'kanë kenë kurrë".

E dukshme, krimi është ende mes nesh. Ndërkaq, jemi shumë larg përjetimit të gjërave më të bukura të kohës. Ky mospërjetim është gjithashtu një krim.

10. Dimri, heshtja, vetmia

Dimri, heshtja dhe vetmia, përbëjnë tre refrene poetike, që zenë një vend jo të paktë, dhe dalëngadalë bëhen aktorë të njëmendt dhe misionarë unikë të shpirtit, heshtjes dhe vetmisë më autentike e më "ekstravagante", që shfaq çdo ditë e çdo natë, pa ndërprerje, shoqëria jonë njerëzore.

Unë, madje, i shoh këta aktorë, të angazhuar në një dialog jo të zakonshëm ndërmjet tyre, direkt mbas shfaqjes së fundit, pak mbasi ulet perdja.

Ja, një moment nga ky dialog, jo fort i lehtë.

Dimri:

Unë jam dimri tjetër, ai që ju nuk e njihni akoma. Unë do t'ju tregoj gjëra jo pak të çuditshme, në një "seancë dimnash", duke u kujdesur për lulet e para, si një "rishtare" e vërtetë, dhe duke paraqitur para jush, ma të mirën fytyrë, fytyrën femërore-dimërore, të bukur shumë e njëkohësisht të thjeshtë si drita.

Heshtja:

Zonja dhe zotërinj, po ju them që në fillim, që ju duhet të dini të heshtni, edhe më mirë se AI. Ju duhet të dini gjithashtu të flisni bukur, edhe me anë të heshtjes. Ju nuk duhet të prishni asnjë qetësi. Që të mos kërkoni pastaj falje për asgjë. Që të mos thoni, ah, nuk e di sesi ka ndodhur, por unë, unë vetë, "zemrës heshtinë ia kam prishë".

Dimri:

I tillë është dimri, pra unë. "Ma mirë nuk mundet." Sa më përket mua, unë e respektoj heshtjen, por nuk jam aspak një tifoz i saj, i çmendur.

Vetmia:

Koka ime është një "azil qeniesh t'vetmueme." Edhe unë, unë, unë vetë, jam vetëm, krejt vetëm, absolutisht vetëm...

Dimri:

Vetmia është një provë e madhe, që duhet ta kalojnë të gjithë, doemos, pa asnjë përjashtim. Kjo është jeta, vetëm ose jo.

Heshtja:

Ju flisni shumë dhe bëni pak, ose aspak. Ky është gabimi juaj i madh. Ju keni akoma errësirë në shpirt. Ju duhet të mësoni urgjentisht, si të heshtni bukur dhe denjësisht, si dhe të bëheni të aftë plotësisht, për të zbërthyer e për të lexuar gjithë sekretet e gjithë sendeve "t'heshtuna."

Dimri:

Ah, çfarë klisheje banale! Unë nuk kam kohë që të merrem me gjëra të kota. Mua, "dimni m'kjan ndër duar". Pra mua, mua... Por në frymën time rritet një trëndafil, ndërsa në sytë e mi, "më shihen fushnjeta".

Vetmia:

Mjaft! Mjaft! Unë jam e mbyllur në dhomën e vetmisë sime. Nuk ka asnjë shenjë shprese ose shkëndijë drite. Unë jam mbytur tashmë në veten time, si në një gotë me ujë.

Dimri:

Aha! Ahu! Ndërsa unë, unë, unë vetë, "due me jetue nji dimën t'përjetshëm". Unë do të rri në tokë, po, në tokë, "me zemrën n'dritore: ushqim për zogat e dimnit".

Heshtja:

Ah për t'errëtin shpend që bart hjekë tue heshtë". Dhe unë, po unë, nuk dua të shtoj asgjë më tepër.

Të tre:

"Heshtja na i heq sytë e nuk na len me pa."

Dimri:

Edhe një herë.

Të tre:

"Heshtja, heshtja, heshtja na i heq sytë e nuk na len me pa".

Heshtja tregon padurim.

Dimri:

Durim, durim, jemi në fund. Së bashku, ju lutem.

Të tre:

"e ma s'kemi me fjetë
E ma s'kemi me folë
e ma s'kemi me ndreqë
ngase rrimë këtu prore
për nji përrallë për tri pika gjumë
e nji pikë esence t'kuqe n'Shpirt".

Pauzë. Pastaj dëgjohen nga larg zhurma stuhish të vjetra e të reja.

Të tre:

"trandun nën kambë mbytun me det
n'dimën ngjye krejt shpirtnash syçilun
zhytena kthjellët ndër ujna t'errët e zhdukena thellë n'askund".

Perdja ngrihet përsëri.

Një shfaqje tjetër fillon.

11. Trupi, muzika, e paguxueshmja

1.Trupi

Poezia e kthen trupin, natyrshëm, në një tempull. Por megjithatë dilema mbetet: ne nuk i dimë akoma fshehtësitë e këtij tempulli, që merr frymë dhe flet, thuajse si një njeri. Ne duhet të jetojmë jo për trupin, por sepse është e pamundur të jetosh pa të. Kështu na thotë Seneka, që në kohëra të hershme. Kjo situatë nuk është aspak e lehtë, sepse nuk jep rast për një ndryshim të shpejtë. Ndërkaq njeriu pret çlirimin e tij nga vetvetja. Kush do ta sjellë këtë çlirim kaq të rëndësishëm, këtë nuk e dimë akoma. Dikush apo shumëkush, ndjehet tanimë si një hije pa trup. Si hija e shumëfishtë e një njeriu pa trup. Më në fund, ne jemi të gjithë, hije në kërkim të trupave tonë, ose, trupat tonë janë duke na kërkuar ne, intensivisht.

E gjithë kjo histori spikat më qartë nëse lexojmë me ngadalë dhe me një ritëm të kohës, vargjet që na çojnë drejt një zbulimi intim e delikat. Heroina lirike nuk kërkon asgjë tjetër, "veç me mujt me pa si ka me m'kullue trupi kujtesë e sende t'heshtuna". Por tashmë trupi pëson edhe një ndryshim tjetër tronditës: "tash s'kam diell as det veç peshën e trupit tim që digjet".

Imazh që përfton imazhe fluturake, pafundësisht, gjersa fshihen a zhduken, diku matanë qiellit. Për t'u shfaqur sërish, në një proces përsosje dhe shtypjeje, që ndodh pa ndërprerje "n'thelbin e zjarmshëm t'trupit". E, njëkohësisht, ky trup "kjan", "i shtypun me taft", aromat dhe stinët treten tanimë bashkë, për të arritur kështu "n'trupin me Dritë". Pra, papritur, trupi është prezent, dhe nuk është më një hije e frikshme, apo një automat i ftohtë dhe pa ndjenja. Trupi i saj bëhet tanimë gjithnjë e më shumë trup. Dhe ky trup nuk është thjeshtë veçse një objekt intim. Ky do të ishte një fund i trupit. Por trupi i vërtetë befas lëshon dritë. Tani mbetet të gjesh trupin që i përshtatet bukur trupit tënd. Pastaj, do të përjetohet, në çastin e çasteve, një shpërthim drite i përbashkët dhe i paharrueshëm.

2.Muzika

Muzika, kjo mrekulli supreme e botës, luan një rol kapital, në përkryerjen e çdo poezie dhe të çdo vargu. Pa muzikën e saj të brendshme, çdo poezi vdes pa lindur akoma. Pa këtë mrekulli, nuk do të funksiononte gjithë harmonia e përgjithshme e një vepre poetike.

Kjo muzikë lind nga fjalët e zgjedhura, me një intuitë gjeniale dhe me një qetësi tejet sovrane. Çdo fjalë i ngjan një instrumenti muzikor të padukshëm. Si të thuash, muzika krijohet, vetvetiu. Edhe gjënë më të egër, edhe ashpërsinë dhe tërbimin më të madh, kjo muzikë e zbut, e çliron nga vetvetja, dhe ia ndryshon natyrën.

Sipas Shekspirit, njeriu që nuk ka muzikë në veten e tij, që nuk preket nga

harmonia e tingujve, ka lindur për tradhti, mashtrim e vjedhje.

Muzika është një ushqim shpirtëror, special.

Ajo i shëron edhe të marrët.

Muzika është tempulli i pafajsisë, poezisë dhe i dashurisë.

Kur muzika është e mrekullueshme, duket sikur nuk ekziston më, asgjë e keqe. Askush nuk mund të jetë indiferent, as armiqësor ndaj saj. Kush urren muzikën, urren veten dhe të tjerët, urren botën dhe zotin. Muzika na çon te origjina, te fillimi i të gjitha fillimeve, te burimi i të gjitha burimeve. Kështu ne bëhemi origjinë dhe burim i gjithçkaje të lirë dhe të bukur.

Pa muzikën, jeta do të ishte një krim tepër i mërzitshëm.

Poezia dhe muzika, jo vetëm që kuptohen mirë me njëra-tjetrën, por edhe dinë të gjejnë në thellësitë e brendshme të njëra-tjetrës, arin e artit të madh.

Edhe poetja Ledia Dushi e njeh mirë sekretin e këtij ari të domosdoshëm, kur është fjala për të krijuar një vepër poetike të vërtetë dhe të aftë për të përballuar sfidat e kohërave të ardhshme. Prandaj ajo është që sot, një sogjetare e mirëfilltë dhe e denjë për misionin e saj të

brishtë dhe jo pak të fortë. Kësisoj, ajo nuk ndjehet mirë, në një "ajër prej muzikash t'rrejshme", as kur i "mungojnë tastet e muzikave t'pandieme", ose kur pohon se, "kurrkush s'i don ma tingujt". E më tej, madje, "Muzika asht sëmurë."

Alarm poetik? Ndoshta, por megjithatë, muzika nuk hesht, sepse tanimë, "Muzikën e luen vedja". Dhe poetja, vijon stoikisht kërkimin e fjalëve, që në një përsëritje të veçantë, japin një muzikalitet dramatik e lirik, të pazakontë.

Si këto shembuj!

Bijn' e bijn' e vdesin sytë e natyrës

Krena e krena e krenaintime e

Tue pa ara e ara e ara t'lame në ar

Muzika, në shkrirjen e saj intime me poezinë, mbetet gjithmonë një bukuri supreme.

3.E paguxueshmja

Gjithë vëllimi poetik përmbledhës, që mban titullin "N'nji fije t'thellë gjaku", provon qartë, që gjithçka nis me një guxim të pastër, vijon me të, dhe kulmon me të, thjesht dhe befasisht. Gjithçka shkon pastaj prore drejt të paguxueshmes, duke shpalosur një mjeshtri sipërore në zbulimin e pasurisë së brendshme të fjalës, në gjetjen e metaforave të reja, apo në konsolidimin e një lirizmi dramatik modern.

Guximi poetik bëhet rrjedhshmërisht një element esencial, pa pozime boshe dhe pa drama artificiale.

Ky element është i dukshëm aq sa duhet dhe vendi i tij është i gjetur mirë, në saj të një mase dhe të një sinqeriteti absolut.

Duke guxuar kësisoj, të paguxueshmen, në çdo rast të mundshëm e të pamundshëm, poezia merr në tempullin e saj, hapësira të pakufishme dhe të panjohura, dhe kështu pa e humbur lidhjen intime me liqenin e qytetit të saj, ajo mund të kalojë natyrshëm në çdo largësi të dëshirueshme apo të padëshirueshme.

Ledia Dushi zotëron një imagjinatë vërtet të pazakontë.

Ajo ka një aftësi të jashtëzakonshme për të krijuar imazhe shumë të çuditshëm, metafora të së sotmes dhe të së ardhmes, apo ndjesi intime e universale, që prekin, zgjojnë ose ftojnë çdo njeri, që të marrë pjesë në një çlirim të përgjithshëm të qenies dhe joqenies.

Ajo ka një marrëdhënie tepër të veçantë me vdekjen, por po ashtu edhe me dramën e jetës. Çdo poezi na përcjell me shumë finesë një dramë të përditshme individuale e planetare, në një botë konkrete, në të cilën, nuk është aspak e lehtë që të mbetesh gjithmonë në anën e një jete të drejtë dhe të bukur.

Kësisoj, historia poetike e jetës dhe vdekjes, është historia apo eposi i të paguxueshmes. Kjo poezi kërkon të zbulojë raporte të reja të njeriut me kohën, me hapësirën dhe me faktet dramatike. Me fjalë të vogla, kjo poezi na transmeton ndjenja dhe ide të mëdha.

Poezia është në këtë rrjedhshmëri të mendimit, kërkimi i të pashpjegueshmes dhe i të paguxueshmes. Poezia nuk kërkon lumturinë, por as fatkeqësinë apo dëshpërimin. Nëse poezia nuk depërton në botën e brendshme të njeriut, të botës dhe madje, të kozmosit, asaj i mungon një gjë mjaft themelore.

Le të shkojmë pak më tej. B. Brecht thotë qartë: "Është fatkeq vendi që ka nevojë për heronj." Ledia nuk ka nevojë për heronj pompozë, as për gjeste heroike groteske. Guximi poetik, natyrisht është tjetër gjë. Në këtë vizion, jetë, do të thotë guxim. Madje, pa guximin, jeta nuk ka kuptim.

Guxim do të thotë karakter.

Guxim do të thotë talent.

Më në fund, ne të gjithë duhet të shkojmë qetësisht, drejt të paguxueshmes. Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë që të gjithë, duhet të guxojmë që të mos bëhemi heronj, por të gjithë duhet patjetër të guxojmë të jemi ose të bëhemi njerëz.

Të jesh njeri apo të bëhesh njeri, ja ku ndodhet heroi i gjithë heronjve.

Ja disa shembuj nga guximi poetik ledian:

1. Zoti ka fytyrën time.
2. Burgu s'asht veç i mbyllun.
3. Femna s'asht njeri.
4. Ndër drita varun n'qiell, kryet tim i vdekun
5. Vras njerëz me frymë.
6. Këndellun n'secilën trandje kozmike.
7. Liria ime...ma e vjetra ndër bimë helmuese.

Këto perla të mendimit dhe guximit poetik tregojnë pa asnjë dyshim, qartësisht, një vrojtim të përpiktë absolutisht të përqëndruar, në eksplorimin e jetëve tona të brendshme dhe të lidhjeve ndërmjet nesh dhe botës.

Një eksploruese unike e të paguxueshmes, e cila, e bën gjithçka pa zhurmë e pa bujë, në një heshtje mjaft domethënëse dhe në një qetësi sovrane, në prag të një shpërthimi të ardhshëm, gjithëpërfshirës. Prandaj, ajo nuk lëshon asgjë nga dora, para se të bëhet e përsosur, me të vërtetë. Ajo guxon t'i japë lirinë absolute, fantazisë dhe imagjinatës. Ajo nuk është e etur për një famë e lavdi boshe. Me tërë modestinë e saj, ajo është gjithnjë e hapur ndaj jetës dhe vdekjes, ndaj mistereve dhe paradokseve, si dhe ndaj çdo fenomeni apo ekzistence të vlefshme, për njeriun e denjë dhe fisnik. Tek ajo, intimiteti i fuqishëm shpirtëror, është i lidhur ngushtë me një sinqeritet biblik dhe me një shikim joshës e tronditës. Nga çdo varg shkëputet një drithërimë ndriçuese, si nga një yll, që sapo ka rënë nga qielli.

I gjithë vizioni i saj poetik ruan gjithnjë një frymë po aq danteske sa edhe misterioze. Duke prekur pikërisht nervin e duhur, ajo bën njëkohësisht autopsinë e saktë të fytyrave njerëzore, apo edhe të fytyrës së botës.

12. Me sy të ri ose Mbisyri

Atje ku nuk mbërrin askush tjetër, poetja e shikon gjthçka ndryshe, me një sy të brendshëm, që mund të zbulojë një dramë për çdo varg. Dhe kësisoj, çdokush që e njeh dramaturgjinë e veprave të mëdha, gjendet befas, përballë një eksplozioni ose para një kryengritje të brendshme, që zhvillohet në thellësi të një heshtjeje kinse profetike. Kështu gjithkush mund të përfshihet shpejt, në një gjendje të vështirë, sa edhe të lehtë. Por, poetja përjeton një situatë unike, në të cilën, ajo thotë "unë s'jam", apo, "qeniet kanë mbetë hije", dhe nga ana tjetër, "tue pritë me u gëzue", "me hungërima prej rane nisim e rrejmë vedin".

Por, situata kulmon më tej. "Përreth, shtazë e femna", shikon ajo, dhe pastaj s'di çfarë të zgjedhë nga tre mundësitë e ofruara, që janë njëra më mizore se tjetra: "kryet a zemrën a sytë me heqë."

Ndërkaq unë shoh një qenie të re, që është e gjitha vetëm sy. Dhe unë, përjetoj gjithashtu, shijen e talljes së ditës, apo ironinë e ironisë sime ironike. Ç'është kjo ditë, që tallet me njeriun, duke ia marrë, gjithçka që zotëronte? Ç'ironi e përgjakshme! Kjo është ndoshta diçka e ngjashme me një vajzë të çuditshme, që mbetet gjithmonë virgjine.

Shpesh, duke parë, njeriu nuk sheh, por nëse i mbyll sytë, ai shikon, madje më mirë se me sy të hapur. Si ta shohësh botën, atëherë? Me ç'sy virgjin? Si mund të shikosh diçka që syri ynë nuk arrin dot ta kapë? Po një lëvizje të shpejtë, një shenjë apo një sinjal? Po një mur sysh, ç'mision ka, në këtë botë nevrike dhe histerike? Ah, ti, amigo, ti ke sy kaq brilantë, por ti e sheh gjithnjë botën, turbull e më turbull. Përse të mungojnë sytë, për të parë gjërat e bukura, por gjërat e shëmtuara, ti i shikon më mirë se askush tjetër?

Nëse syri është i kthjellët, i tërë njeriu është i kthjellët. Nëse syri është i turbullt, i tërë njeriu është në errësirë. Por kur syri yt i brendshëm është i verbër, errësira do të jetë më e tmerrshme se ajo e ferrit. Këtu duket qartë rëndësia e jashtëzakonshme e syrit të brendshëm.

Përse njeriu shpesh nuk beson as te sytë e tij?

A mos e ka fajin syri i keq, syri magjik, apo syri i brendshëm? Ti nuk ke guxim të shikosh brenda teje. Ti nuk e shikon dot zemrën, as gjakun tënd. Asnjë forcë e jashtme, nuk bën dot asgjë, pa forcën e brendshme. Gjithçka mund të fitohet vetëm nga brenda, njëlloj si një fortesë. Ti duhet të shikosh dhe të njohësh, ç'luan apo tigër, ndodhet brenda teje.

Nuk sheh syri, sheh mendja. E dimë, e dimë.

Absolutisht.

Por, përse ka sy, që nuk derdhin lot kurrë, ose sy që qajnë pa pushim? Përse ka sy dinakë dhe sy të ndershëm? Përse mund të verbohesh nga kaltërsia e syve të një vajze të bukur? Për sa sy, ka nevojë njeriu? Si mund t'u përkasësh kohëve që do të vijnë?

Me një Mbisy.

Me një Mbisy.

Me një Mbisy.

Në këtë mënyrë, ti do të shikosh gjëra, që nuk mund t'i shikojë askush tjetër, në botë. Ti do të shikosh jo vetëm gjëra të papara, por edhe do të ëndërrosh, "sy ndër sy me nji fajkue", ndërkohë që "jeta asht ba drapën" dhe ndrit një "hanë e rrejshme". Për të mbërritur sa më qetësisht dhe sa më natyrshëm, te konkluzioni final: "andrra asht jeta". Po, kështu është. Këtë nuk mund ta ndryshojmë. Por megjithatë, ti gjen një shteg sekret, dhe zbulon finalen e dytë, duke uruar si një fëmijë largpamëse: "Mirë ju gjetsha Andrra!" Pra, koha mund të sfidohet me ëndrra të reja.

Dhe, prandaj, një poezi e vërtetë, nuk e njeh pushtetin e kohës.

Një si kjo, për shembull:

Shpirt për shpirt me u kundrue e mos me pasë t'ngime

aromash e tingujsh e rrezesh e qiejsh t'papërshkuem

me u amshue me u shelbue t'Përdritun t'Përdritun t'Përdritun

Shpirt për Shpirt t'paterrë t'patokë

me Miq e Miq e Miq t'pamundun

që kisha dashtë me i marrë n'grykë sa herë kisha dashtë me dashtë

Tashmë, s'më mbetet më gjë tjetër, përveçse të kujtoj thënien fillestare të kësaj sprove:

"Çdo poezi duhet të shkruhet si të ishte

poezia e parë e botës."

Bruxelles, janar 2020



LEXUES TË MIRË DHE SHKRIMTARË TË MIRË

nga Vladimir Nabokov

"Si të jesh lexues i mirë" ose "Të tregosh mirësi ndaj autorëve", diçka e përafërt si kjo mund të jetë nëntitulli i shqyrtimeve të ndryshme që bëj për autorë të ndryshëm, sepse synoj t'u qasem me dashuri, duke u përqendruar në detaje të bukura dhe të qëndrueshme të disa kryeveprave të letërsisë evropiane. Njëqind vjet më parë, në një letër drejtuar të dashurës së tij, Gustav Floberi bëri këtë vërejtje: "Sa studies për t'u patur zili do të ishte ai që do të arrinte të njihte fund e krye, të paktën gjatë libra".

Gjatë leximit, duhen vënë re dhe treguar tepër kujdes për detajet. Nuk ka asgjë të keqe të bësh përgjithësime kur kjo ndodh pasi ke mbledhur me dashuri detajet më domethënëse të librit. Por nëse fillohet me një përgjithësim të gatshëm, atëherë fillohet gabim dhe i je larguar librit përpara se të fillosh ta kuptosh. S'ka gjë më të mërzitshme dhe padrejtësi më të madhe ndaj autorit se sa të fillosh të lexosh, le të themi, "Zonja Bovari", me idenë e paracaktuar se romani denoncon borgjezinë. Duhet të kujtojmë gjithmonë se një vepër arti në çdo rast krijon një bote të re, prandaj gjëja e parë që duhet të bëjmë është ta studiojmë këtë botë të re sa më thellë, duke iu qasur asaj si diçka krejt e re, e cila nuk ka asnjë lidhje të dukshme me botët që tashmë njohim. Kur kjo botë e re është studiuar thellë, atëherë dhe vetëm atëherë le të shqyrtojmë lidhjet e saj me botët e tjera, degët e tjera të dijes.

Një pyetje tjetër: A mund të presim që të mbledhim informacione për vendet dhe kohën nga një roman? A mund të ketë njeri kaq naiv sa të mendojë se mund të mësojë ndonjë gjë mbi të kaluarën nga këto best sellërat e bollshëm që shiten prej reklamave që bëjnë klubet e librave duke u vënë etiketën e romaneve historikë? Po çfarë mund të themi për kryeveprat? A mund të mbështetemi në tablonë e krijuar nga Jane Austen për Anglinë e pronarëve të tokave me tituj fisnikërie dhe peizazhe të bukura, kur gjithçka që ajo njihte ishin mjediset e kishës anglikane? Dhe "Shtëpia e zymtë" e Dikensit, kjo romancë fantastike në një Londër fantastike, a mund ta quajmë studim të Londrës njëqind vjet më parë? Sigurisht që jo. Dhe e njëjta vlen edhe për romane të tjerë të tillë si "Parku Mansfield" i Xhejn Ostenit, "Rasti i çuditshëm i Dr. Jenkyll dhe zotit Hyde" i Robert Lousi Stevenson-it, "Kur dashuronte Suani" i Marcel Proust-it, "Metamorfoza" e Franc Kafkës, "Uliksi" i James Joyce-it. E vërteta është se romanet e shkëlqyera janë përralla të shkëlqyera, dhe romanet që sapo përmenda janë përralla të jashtëzakonshme.

Koha dhe hapësira, ngjyrat e stinëve, lëvizjet e muskujve dhe mendjeve, të gjitha këto janë për shkrimtarët me aftësi gjeniale (me aq sa mund të hamendësojmë ne dhe besoj besojm se nuk po gabojmë) jo sipas koncepteve tradicionale që mund të huazohen nga bibliotekat qarkulluese të të vërtetave publike por sioas një varg befasish unike që artistët mjeshtër kanë mësuar t'i shprehin në mënyrën e tyre unike. Zbukurimi i vendeve të zakonshme u është lënë autorëve minor: ata nuk shqetësohen për ndonjë rishpikje të botës, thjesht përpiqen të zhvasin sa më shumë të munden nga rendi i caktuar i gjërave dhe modelet tradicionale të prozës letrare.

Kombinimet e ndryshme që këta autorë minor janë në gjendje të krijojnë brenda këtyre kufijve të caktuar mund të jenë mjaft zbavitës, deri diku kalimtare sepse lexuesit minor pëlqejnë të njohin idetë e tyre të maskuara këndshëm. Por shkrimtari i vërtetë, ai që rrotullon planetet, ai modelon një njeri në gjumë dhe godet në brinjë atë që po fle, ky lloj autori nuk ka vlera të përcaktuara, duhet t'i krijojë vetë. Arti i të shkruarit është punë shumë e kotë nëse nuk nënkupton para së gjithash artin e të parit të botës si mundësi trillimi. Lënda e kësaj bote mund të jetë mjaftueshëm reale (për sa i përket realitetit), por nuk ekziston fare si një tërësi e pranuar: është kaos, dhe në këtë kaos autori thotë "nisu!" duke lejuar që bota të shpërthej në dritë dhe të shkrihet. Kështu rikombinohet me anë të atomeve të veta, jo thjesht në pjesët e tij të dukshme dhe sipërfaqësore.

Shkrimtari është njeriu i parë që i jep trajtë dhe formon objektet natyrore që përmban lënda. Ato manaferrat atje janë të ngrënshme. Ajo krijesë pika-pika që rrëzohej duke ecur në rrugën ku po kaloja mund të ishte e squllur. Ai liqen midis atyre pemëve do të quhet "Liqeni opal" ose, më artistikisht, "Liqeni i ujit të enëve". Ajo mjegull është një mal dhe ai mal duhet të pushtohet. Mbi një shpat pa gjurmë njeriu ngjitet artisti mjeshtër, dhe në krye, në një kreshtë me erë, kë mendoni se takon ai? Takon lexuesin që mezi merr frymë për shkak të lumturisë që ndjen, dhe atje përqafohen vetvetishëm dhe lidhen përgjithmonë nëse libri zgjat përgjithmonë.

Një mbrëmje në një kolegj të largët provincial përmes të cilit më ndodhte të bëja një vrap të lehtë kur isha në një turne të zgjatur leksionesh, sugjerova një kuiz të vogël - dhjetë përkufizime për një lexues, dhe nga dhjetë, studentët duhej të zgjidhnin katër përkufizime që do të kombinoheshin për të krijuar një lexues të mirë. E kam humbur listën, por me sa mbaj mend përkufizimet ishin pak a shumë si më poshtë. Zgjidhni katër përgjigje për pyetjen se si duhet të jetë lexuesi për të qenë lexues i mirë:

1. Lexuesi duhet të jetë anëtar i një klubi që shpërndan libra për lexim.
2. Lexuesi duhet ta identifikojë veten me heroin ose heroinën.
3. Lexuesi duhet të përqendrohet në aspektin social-ekonomik.
4. Lexuesi duhet të parapëlqej një histori me veprim dhe dialog kundrejt asaj pa asnjërën prej tyre.
5. Lexuesi duhet ta ketë parë filmin e mbështetur tek libri.
6. Lexuesi duhet të jetë edhe vetë autor fillestar shkrimesh.
7. Lexuesi duhet të ketë imagjinatë.
8. Lexuesi duhet të ketë kujtesë.
9. Lexuesi duhet të ketë një fjalor.
10. Lexuesi duhet të ketë shqisë artistike.

Studentët mbështetën identifikimin me emocionin, veprimin dhe aspektin shoqëror - ekonomik ose historik. Sigurisht, siç mund ta keni marrë me mend, lexuesi i mirë është ai që ka imagjinatë, kujtesë, fjalor, dhe njëfarë shqise artistike, shqisë të cilën përpiqem ta zhvilloj tek vetja dhe tek të tjerët, sa herë që kam mundësi.

Rastësisht, e përdora fjalën "lexues" shumë lirshëm. Është vërtetë interesante se si libri nuk mund të lexohet: ia vetëm mund të rilexohet. Lexuesi i mirë, lexuesi madhor, është lexues aktiv dhe krijues pra është një rilexues. Dhe do t'ju them pse. Kur e lexojmë për herë të parë një libër, vetë procesi i lëvizjes me vështirësi të syve nga e majta në të djathtë, rresht pas rreshti, faqe pas faqe, kjo punë e ndërlikuar fizike me librin, vetë procesi i të mësuarit për sa i përket hapësirës dhe kohës dhe se çfarë përmban libri, ky process qëndron midis nesh dhe vlerësimit artistik. Kur shikojmë një pikturë nuk kemi pse t'i lëvizim sytë në një mënyrë të veçantë edhe nëse, si në një libër, fotografia përmban elemente të thellësisë dhe zhvillimit. Elementi i kohës nuk shfaqet shumë gjatë kontaktit të parë me një pikturë. Kur lexojmë një libër, na nevojitet kohë që të njihemi mire me të.

Ne nuk kemi ndonjë organ fizik (siç kemi syrin në rastin e pikturës) që e rrok pamjen në tërësi dhe më pas të mund të shijojmë detajet. Por pas leximit të dytë, të tretë, ose të katërt që bëjmë, në një kuptim, sillemi me një libër siç bëjmë me një pikturë. Sidoqoftë, të mos e ngatërrojmë syrin fizik, këtë kryevepër të përbindshme të evolucionit, me mendjen, një arritje edhe më e përbindshme. Një libër, pavarësisht se çfarë është, është vepër e trillimit ose vepër e shkencës (vija ndarëse midis të dyjave s'është aq e qartë sa besohet në përgjithësi). Një vepër letrare i drejtohet para së gjithash mendjes. Mendja, truri, shtylla kurrizore që të ther janë, ose duhet të jenë, instrumentet e vetme që përdoren për një libër.

Tani, duke qenë kështu, ne duhet të parashtrojmë pyetjen se si funksionon mendja kur lexuesi apatik përballet me librin shkëlqimplotë. Së pari, gjendja shpirtërore apatike zhduket, dhe për mirë ose për keq lexuesi hyn në shpirtin e lojës. Përpjekja për të filluar një libër, veçanërisht nëse vlerësohet nga njerëz të cilët lexuesi i ri fshehtësisht i sheh si të dalë mode ose shumë serioz, është shpesh e vështirë për t'u bërë si përpjekje por pasi të bëhet, shpërblimi është i madh. Meqenëse artisti mjeshtër e përdori imagjinatën për krijimin e librit, është e natyrshme dhe e drejtë që edhe lexuesi i një libri ta përdorë edhe imagjinatën e tij.

Sidoqoftë, në rastin e lexuesit ekzistojnë të paktën dy lloje të imagjinatës. Le të shohim atëherë se cili nga të dy është i duhuri për ta përdorur gjatë leximit të një libri. Së pari, ekziston një lloj imagjinate deri diku e nivelit të ulët që kërkon të mbështetet tek emocionet e thjeshta dhe ka pa dyshim natyrë vetjake. (Ka nënndarje të ndryshme në këtë pjesën e parë të leximit emocional.) Një situatë në libër ndjehet fort sepse na kujton diçka që na ka ndodhur ose i ka ndodhur dikujt që njohim ose për të cilin na kanë treguar. Ose, sërish, lexuesi e çmon librin më së shumti sepse ngjall përfytyrimin e një vendi, një peizazhi, një mënyre jetese të cilën ai me nostalgji e kujton si pjesë të së kaluarës së tij. Ose, dhe kjo është gjëja më e keqe që një lexues mund të bëjë, ai e njëjtëson (identifikon) veten me një personazh të librit. Ky lloj imagjinate e nivelit të ulët s'është lloji i imagjinatës që do të doja të përdorin lexuesit.

Atëherë cili qenka instrumenti autentik që duhet të përdoret nga lexuesi? Është imagjinata jopersonale dhe kënaqësia artistike. Ajo që duhet të krijohet, mendoj, është një ekuilibër harmonik artistik midis mendjes së lexuesit dhe mendjes së autorit. Duhet të qëndrojmë pak të shkëputu dhe të kënaqemi në këtë largësi ndërsa në të njëjtën kohë kënaqemi me dëshirë, e pasion, shijojmë me lot dhe drithërima thurimën e brendshme të një kryevepre të caktuar. Të jesh vërtet objektiv në këto çështje është natyrisht e pamundur. Gjithçka që ka vlera është deri diku subjektive. Për shembull, të ulem atje thjesht mund të jetë ëndrra ime, dhe unë mund të jem makthi yt. Por ajo që dua të them është se lexuesi duhet ta dijë se kur dhe ku ta mbaj nën kontroll imagjinatën dhe këtë e bën duke provuar ta rrok plotësisht botën e veçantë që autori i vendos në dispozicion. Ne duhet t'i shohim dhe dëgjojmë gjërat, duhet t'i përfytyrojmë në aspektin pamor dhomat, rrobat, mënyrën si sillen personazhet e një autori. Ngjyra e syve të protagonistes Fanny Price në "Parku Mansfield" dhe mobilimi i dhomës së saj të vogël dhe të ftohtë janë të rëndësishme.

Të gjithë kemi natyra të ndryshme, dhe mund t'ju them që temperamenti më i mirë që një lexues duhet të ketë, ose të zhvillojë, është ndërthurja e temperamentit artistic me atë shkencor. Vetëm artisti i zjarrtë priret të jetë tepër subjektiv në qëndrimin e tij ndaj një libri, kështu që një gjakftohtësi shkencore e gjykimit do ta zbuste temperaturën e lartë të përfshirjes intuitive. Nëse një lexues i hamendësuar shkëputet plotësisht nga pasioni dhe durimi, nga pasioni i një artisti dhe durimi i një shkencëtari, ai vështirë se do të shijojë letërsi të madhe.

Letërsia nuk lindi ditën kur një djalosh thirri "ujku!" ndërsa një ujk doli nga lugina e Neandertalit i ndjekur nga ujk i madh i përhimtë fill pas tij: letërsia lindi në ditën kur një djalosh ia dha vraprit duke thirrur "ujku! ujku!" ndërsa s'kishte kurrfarë ujku duke rendur pas tij. Fakti se djaloshi i shkretë, e i pafat ngaqë gënjente pa karar, një ditë u shqye nga bisha e vërtetë është pa ndofarë rëndësie. Ja çfarë është e rëndësishme, midis ujkut të fshehur midis barit të gjatë dhe ujkut në një rrëfenjë të gjatë ka një hapësirë të ndritshme midisëse. Kjo ndërkohë, ky prizëm, është arti i letërsisë.

Letërsia është shpikje. Shkrimësia është trillim. Ta quash një rrëfim, histori të vërtetë, është fyerje si për artin ashtu edhe për të vërtetën. Çdo shkrimtar i madh është një mashtrues i madh, sepse kështu është edhe natyra. Natyra mashtron gjithmonë. Duke nisur që nga mashtrimi i thjeshtë i shumimit deri tek iluzioni jashtëzakonisht i stërholluar i ngjyrave mbrojtëse tek fluturat ose zogjtë, ekziston në natyrë një sistem i mrekullueshëm magjish dhe magjepsjesh. Shkrimtari i prozës letrare thjesht ndjek prirjen e Natyrës.

Duke iu rikthyer për një çast djaloshi teveqel në pyll, çfarë ndodh mund ta themi kësisoj: magjia e artit ishte nën hijen e ujkut që ai e shpiku me paramendim, ëndrra e tij për ujkun; pastaj historia e dredhive që përdori krijoi një histori të mirë. Kur më në fund ai vdes, historia përmban një mësim të mirë për ata që rrinë dhe e dëgjojnë në errësirë, përreth zjarrit të kampit. Por ai ishte magjistari i vogël. Ai ishte shpikësi.

Janë tre kritere me të cilat mund të përcaktohet shkrimtari: mund të përcaktohet si tregimtar, si mësues dhe si magjistar. Një shkrimtar u madh i ndërthur të treja, tregimtarin, mësuesin, magjistarin, por është magjistari ai që mbizotëron dhe e bën atë shkrimtar të madh.

Tek tregimtari presim argëtim, emocion të thjeshtë mendor, përfshirje emocionale, kënaqësinë e udhëtimit në një vend të largët në hapësirë ose kohë. Një mendje pak më ndryshe, por jo domosdo e nivelit më të lartë, kërkon mësuesin tek shkrimtari. Propagandistin, moralistin, profetin, kjo është prirja në rritje për të gjetur tek shkrimtari. Mund t'i drejtohemi mësuesit jo vetëm për edukimin moral, por edhe për njohuri të drejtpërdrejta, për fakte të thjeshta. Për fat keq, kam njohur njerëz, qëllimi i të cilëve për të lexuar romancier francez dhe rus ishte të mësojnë diçka rreth jetës në Parisin gazplot ose në Rusinë e zymtë. Më në fund, dhe para së gjithash, një shkrimtar i madh është gjithmonë një magjistar i madh, dhe këtu vijmë tek pjesa me të vërtetë emocionuese, kur përpiqemi të kuptojmë magjinë individuale të gjenisë së tij krijuese dhe të studiojmë stilin, imazhet, modelin e romaneve apo poezitë.

Të tre tiparet e shkrimtarit të madh, magjia, tregimi, mësimi, priren të bëhen njësh në një përshtypje të vetme e cila mbart rrezatimin e bashkuar dhe unik, pasi magjia e artit mund të jetë e pranishme në eshtrat e tregimit, në palcën e mendimit. Ka kryevepra të mendimit të thatë, të kulluar, të organizuar që provokojnë tek ne një mashtrim artistik po aq fort sa një roman si "Parku Mansfield" ose si çdo rrjedhë e pasur me imazhe joshëse Dikensiane. Më duket se një formulë e mirë për të testuar cilësinë e një romani është, në planin afatgjatë, një shkrirje e saktësisë së poezisë me intuitën e shkencës. Për ta ndjerë atë magji, një lexues i mençur lexon librin e gjeniut jo me zemrën e tij, jo aq shumë me trurin e tij, por me shtyllën e tij kurrizore. Aty ndodh rrënqethja e rrëfenjës së gjatë edhe pse duhet të mbajmë pak lar, pak të shkëputur kur lexojmë. Pastaj me një kënaqësi që është edhe joshëse dhe intelektuale, ne do të shohim artistin tek ndërton kështjellën e tij prej rëre dhe do të shohim si kështjella prej rëre kthehet në kështjellë prej çeliku të fortë dhe qelqnaje të hijshme.

Përktheu: Granit Zela

EUROPEAN UNION
PRIZE FOR LITERATURE